



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Financë- Kontabilitet”

Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Drini SALKO

Dr. Erinda IMERAJ

Dhjetor / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në “Financë-Kontabilitet”**


1	IAL aplikues:	Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Financë Kontabilitet
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Financë-Kontabilitet”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASH me Nr. 4390 Prot, datë 23.10.2000
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër i QSHA Nr. 230, datë 28.05.2021
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit në vitin akademik 2022-2023	24 PAE / 14 PAK Për sa i përket ngarkesës (67 % / 33 %)
18	Numri i studentëve:	2020-2021 95 studentë; 2021-2022 93 studentë; 2022-2023 85 studentë.
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër u krijua me VKM nr.167 date 28 Maj 1991 mbi bazën e Institutit të Lartë Pedagogjik, i hapur në vitin 1957. USH ushtron veprimtarinë e tij në baze të akteve ligjore, nënligjore dhe kuadrit rregullator të brendshëm. që nga kjo periudhe USH ka zgjeruar aktivitetin e tij dhe sot në përbërjen e tij operojnë 6 Fakultete si njësi kryesore. Fakulteti i Ekonomisë (FE) si një nga këto gjashtë fakultete është njëkohësisht dhe njësi kryesore përgjegjëse e programit Bachelor në Finance Kontabilitet (FK). FE i hapur në Shtator 1993, me vendim nr.349 date 10.08.1992, fillimisht me një degë, Administrim Biznes . në vitin 2001, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës u miratua edhe hapja e dy degëve të tjera, Finance Kontabilitet dhe Marketing Turizëm. Aktualisht FE përfshin 3 departamente në strukturën e tij ku Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit (DFK) që funksionin që nga Shtatori 2010 është njësi baze përgjegjëse e këtij programi studimi.

Programi i studimit Bachelor në "FK" është hapur në Tetor të vitit 2000 me urdhër nr.4390/prot date 23.10 2000 të MASH. Programi i studimit ofrohet në gjuhën shqipe dhe ka për qëllim përgatitjen e specialistëve në fushën e financës bankës, sigurimeve dhe pasurisë se paluajtshme duke i specializuar në këto drejtime të tregut të punës të diplomuarit në këtë program. Programi i studimit realizohet me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale është tre vite akademike. Programi i studimit Bachelor në "FK" është organizuar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "*Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL*". Qëllimi i programit të studimit siç përcaktohet nga vetë institucioni është pajisja e studentëve me njohuri gjithëpërfshirëse mbi financën, kontabilitetin, me vendimmarrjen dhe mjetet e zbatimit të funksionit financiar, në të gjithë tipet e sipërmarrjes, institucioneve financiare, sistemit tatimor e doganor si dhe njohuritë mbi vlerësimin dhe investimin në tregun financiar. Programi i studimit ofrohet nga DFK që ofron programe studimi në ciklin e parë dhe ciklin e dytë dhe ka një eksperiencë të gjatë në lidhje me ofrimin e programeve në fushën e financës duke aplikuar e përfshirë në kurikulat e veta lëndë sipas kërkesave të tregut të punës. Në vitin akademik 2021-2022 departamenti përbehej nga 12 PAE dhe 16 PAK. Në vitin akademik aktual 2022-2023 departamenti ka në përbërjen e tij 12 PAE dhe 11 PAK. Personeli me kohë të plotë krahas angazhimit në mësimdhënie, është i përfshirë dhe në punë kërkimore-shkencore në funksion të mësimdhënies dhe zhvillimit ekonomik lokal/ kombëtar.

DFK, bashkëpunon me institucione të tjera të arsimit të lartë (kombëtare dhe ndërkombëtare) në fushën e mësimdhënies, organizimit të konferencave shkencore dhe pjesëmarrjen si partnerë në projekte të ndryshme. Departamenti bashkëpunon gjithashtu me institucione të tjera private dhe publike për arritjen e objektivave të tij në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, i përbërë nga **Prof.Dr.Drini Salko** dhe **Dr. Erinda Imeraj**, i miratuar nga Bordi i Akreditimit dhe ASCAL, është mbështetur në këtë proces nga koordinatori teknik i ASCAL Znj. Majlinda Demirneli, në realizimin e procesit të vlerësimit të jashtëm, u mbështet në një seri dokumentesh dhe kërkesash të ndryshme në lidhje me standardet dhe mënyrën e funksionimit të njësive përkatëse që mbulojnë këtë program. Burim i rëndësishëm për vlerësimin e jashtëm shërbeu Raporti i Vlerësimit të Brendshëm i USH i cili është rezultat i bashkëpunimit ndërmjet stafit akademik dhe atij administrativ dhe pasqyron situatën e procesit të formimit dhe të zhvillimit në FE, si dhe në DFK. Një rol të rëndësishëm në këtë vlerësim pati vizita në vend që u realizua pranë USH, dhe FE në datat 12 dhe 13 Korrik 2023. Në bazë të agjendës së përgatitur paraprakisht dhe të dakordësuar me institucionin (USH dhe FE), u realizuan takime me drejtues të njësisë kryesore/bazë e struktura të tjera të këtij institucioni, ku u verifikuan dhe u shqyrtuan edhe një sërë dokumentesh të dosjes përkatëse të aplikimit për akreditim të këtij programi.


Gjatë vizitës në Institucion u realizuan takime me: Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, Përgjegjësën e DFK, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik që mbulon programin e studimit, studentët, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e Kurrikulës dhe Cilësisë, Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, Zyrën e Shërbimit të Studentëve, Zyrën e Hartimit dhe Menaxhimit të Projekteve, Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Sekretarinë Mësimore. Gjithashtu, u realizua një vizitë edhe në mjediset mësimdhënëse të këtij Institucioni, sallën e kompjuterëve, bibliotekë, etj.

Në verifikimin e të dhënave u përdor metoda e marrjes së mostrës, duke nxjerrë në mënyrë të rastësishme kampionët për verifikim. Kjo metodë u përdor në verifikimin e të dhënave lidhur me cilësinë e studentëve, të dhënat e studentëve në sekretari, të dhënat për hyrje dhe dalje të studentëve në vite, lidhur me frekuentimin e leksioneve dhe të seminareve, verifikimin e praktikave të rekrutimit të stafit, etj. Së fundmi, vlerësojmë bashkëpunimin me të gjithë strukturat përkatëse të Institucionit që na mundësuan plotësimin e kërkesave tona për dokumentacion shtesë, lidhur me aspekte të caktuara në shërbim të një vlerësimi sa më objektiv. Raporti është hartuar në bashkëpunim të ngushtë midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 14.11.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 221/46 Prot, datë 14.11.2023. Universiteti "Luigj Gurakuqi", më datë 04.12.2023, njofton me anë të shkresës me Nr.3624/1 Prot, datë30.11.2023 "Përgjigje ndaj Draft Raportit të Vlerësimit të Jashtëm".

Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

1. Për Komentin që i përket Standardit II.1.Kriteri 2;



4



GVJ duke shqyrtuar programin mësimor si dhe përmbajtjen e syllabuseve konstaton që arrihet të transmetohen njohuri të fushës së financës dhe kontabilitetit. Kjo bën të mundur që studentët që përfundojnë këtë program mund të punësohen si specialistë në finance apo kontabilitet brenda hapësirës së njohurive të një programi Bachelor si dhe të mund të vazhdojnë programin e ciklit të dytë në profilet e këtij programi pas diplomimit të tyre. Plani mësimor është i qartë dhe në të janë të paraqitura lëndët/ modulet me gjithë ngarkesën e tyre në mënyrë që të përmbushen më mirë objektivat e mesimnxenies nga ana e studentëve do të sugjerohet disa rregullime kryesisht teknike që nuk prekin përmbajtjen e programit të propozuar. Kështu:

- Bazuar në fushën e programit me fokus financën dhe kontabilitetin në vitin e parë semestri i II-te mund të përfshihet lënda “*Matematika Financiare*”. Studentët tashme kanë marrë në semestrin e I-re njohuritë e përgjithshme në matematikë dhe në semestrin e II fokusohen tek matematika financiare që tashme është e rëndësishme në kuadrin e aplikimeve në finance;
- Në program të mund të zinin me shume peshe njohuritë në *finance dhe kontabilitet* në funksion të këtij qëllimi mund të bëhen edhe rregullime si më poshtë vijon:
- *Lënda kontabilitet i kosto dhe drejtim të ndahej në dy module me emërtimet përkatëse: Kontabilitet Kosto dhe Kontabilitet Drejtim. Në vend të lendes HSHM e cila të mos ketë dy module por vetëm Drejtimin e operacional. Studenti në vitin e parë ka marrë njohuritë baze të menaxhimit me lenden me këtë emërtim;*
- *Lënda “Drejtim Investimesh dhe Finance Ndërkombëtare” që ka dy module sipas emërtimeve të mësipërme të reduktohej në një në lenden Investime”. Kjo pasi moduli Financa Ndërkombëtare” për vete specifikën dhe nivelin e vështirësisë mund të zhvillohet në ciklin e dytë të studimeve të nivelit Master;*
- *Bazuar në rëndësinë e lendeve me zgjedhje që i krijojnë mundësi studentit të “profilizohet” me shume në finance dhe kontabilitet apo edhe të rrisë njohuritë në fushën e ekonomisë do ishte me mire që të reduktoheshin disa lende kryesisht të gjuhës së huaj si, Turqisht, Gjuha Malazeze; Kulture gjuhe, dhe të përfshiheshin lende të tilla si “E-banking dhe financa; “E-marketingu, e-biznesi” Shkrimi akademik dhe komunikimi në biznes “ të cilat krahas lendeve të tjera me zgjedhje do plotësonin me mire përmbajtjen e programit;*

Për sa më sipër kuptohet se institucioni planifikon që të përmirësojë planin mësimor në vitin e ardhshëm akademik. GVJ vlerëson se marrja në konsideratë e rekomandimeve për përmirësimin e planit mësimor (që nuk ka pasur ndryshime gjatë 3 viteve të fundit) do rrisë me tepër cilësinë e këtij programi duke përmbushur objektivat si një program bachelor në fushën e Financës dhe Kontabilitetit. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**


2. Për Komentin që i përket Standardit II.2.Kriteri 1;

Këtu kemi të bëjmë vetëm me një saktësim të PAK nga (13 të vendosur në raport në 12) ndër të cilët nga 4 me tituj/grada të vendosur në raport në 3. **Kjo është saktësuar në raportin final.**

3. Për Komentin që i përket Standardi III.3.Kriteri 1;



5




GVJ argumenton se në vlerësimin e standartit është bazuar në shqyrtimin e syllabusve të programit ku në një numër të tyre provimi përfundimtar vlerësohej në 80 % të pikëve totale gjë që nuk mund të ezaurohen nga rregulloret e brendshme të institucionit. Jemi dakord me GVB që do të propozojë ndryshime në rregulloren e brendshme të studimeve në USH për këtë objekt vlerësimi të rëndësishëm. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

4. Për Komentin që i përket Standardi 4.1.4.Kriteri 2;


GVJ sqaron se përqindjet e paraqitura në RVJ për të tre vitet akademike janë referuar tabelave në RVB 2020- 2023, 12.1- 12.3, ku specifikisht është raportuar ngarkesa e secilit personel akademik për programin e studimit sipas planit mësimor për secilin vit akademik. Tabela e cituar në komentet nga GVB tab 4, përfshin ngarkesën e stafit akademik të këtij program studimi, për disa nivele të programeve të studimit dhe vetëm për një vit. GVJ pranon që ky raport PAE/ PAK është përmirësuar në vitin e fundit por për vitet në shqyrtim raporti është nën nivelin e rekomanduar në VKM Nr. 418, datë 10.05.2017. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

LISTA E SHKURTIMEVE

ASCAL	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë
DFK	Departamenti i Financës Kontabilitetit
FE	Fakulteti i Ekonomisë
FK	Financë- Kontabilitet
IAL	Institucion i Arsimit të Lartë
GVB	Grupi i Vlerësimit të Brendshëm
GVJ	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm
KGSC	Komisioni i Garantimit të Standardit të Cilësisë
NJSBC	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
RVB	Raport i Vlerësimit të Brendshëm
NJZHKC	Njësia e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë
USH	Universiteti i Shkodrës
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZKA	Zyra e Karrierës dhe Alumni
ZMBN	Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore



6



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë Kontabilitet”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë – Kontabilitet (FK) që ofrohet nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” (USH) nuk bie ndesh me interesa kombëtare. Programi bazohet në Statutin e institucionit si dhe përkon edhe me zhvillimin institucional, akademik dhe shkencor të përcaktuara në strategjinë e zhvillimit të USH dhe strategjia e kërkimit shkencor për periudhën 2022-2026 të cilës i kane paraprirë dy strategjitë ajo mbi zhvillimin dhe strategjia e kërkimit shkencor dhe atë të mësimdhënies për vitet 2017-2022. Studentet që përfundojnë këtë program kane mundësi që në kuadër të zhvillimeve ekonomiko sociale të dekadës se fundit të jene pjese e tregut të punës, kryesisht në sektorin e financës dhe kontabilitetit duke kontribuar në nivel lokal, rajonal apo edhe kombëtar në këtë sektor të rëndësishëm të ekonomisë. <u>Referenca:</u> <i>Statuti i USH</i> <i>Strategjia e zhvillimit të USH 2022-2026</i> <i>zhvillimit të USH 2017-2022</i> <i>Startegjia e kërkimit shkencor 2022-2026</i> <i>Strategjia e kërkimit shkencor 2017 - 2022</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Ky program bazohet në përputhje me qëllimin dhe misionin e USH dhe fushën e veprimtarisë se tij. Këtë e bazojmë mbështetur në shqyrtimin dokumentacionit themelore të institucionit si statuti (neni 4 faqe 4), strategjia e hartuar nga institucioni (faqe 9-14) dhe kuadri rregullator të tij në nivel institucional, njësie kryesore dhe njësi bazë <u>Referenca:</u> <i>Statuti i USH</i> <i>Strategjia e zhvillimit të USH 2020-2030</i>

<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor në FK që ofrohet nga USH është bazuar në dokumentet themelore të zhvillimit institucional. Ky program është në funksion të zbatimit të vizionit, prioriteteve dhe objektivave të vendosura në Strategjinë e zhvillimit të USH 2022- 2026 të cilës i kane paraprirë dy strategjitë mbi kërkimin shkencor dhe atë të mësimdhënies për vitet 20217-2022. Në rregulloren e institucionit janë të përcaktuara një spektër i gjere profesionesh dhe drejtimet akademike ku përfshihet dhe fusha e këtij programi.</p> <p><u>Referenca:</u> Statuti i USH Rregullore e USH Strategjia e zhvillimit të USH 2022-2026</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>USH u krijua me VKM nr.167 date 28 Maj 1991 mbi bazën e Institutit të Larte Pedagogjik, i hapur në vitin 1957. Institucioni krahas përvojës se gjate ofron edhe kapacitete dhe burime të mjaftueshme akademike për të realizuar programet e studimit që zhvillohen aktualisht dhe që kane ardhur në vite duke u rritur në numër por edhe në cilësinë që ofrojnë. Një zhvillim mjaft i rëndësishëm është edhe përmirësimi i dukshëm dhe ofrimi i një infrastrukture mjaft të mire për zhvillimin e programeve mësimorë të ofruara ku përfshihet edhe programi i studimit Bachelor në Finance Kontabilitet. Dega Finance Kontabilitet është miratuar me vendim të Ministrisë se Arsimit dhe Shkencës që në vitin 2000 dhe ka tashme rreth 21 vite që zhvillohet si program studimi duke krijuar profilin e tij të qëndrueshëm si një program bashkëkohore.</p> <p><u>Referenca:</u> Statuti i USH Strategjia e mësimdhënies 2017-2022 dhe 2022-2026</p>
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njesisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të</p>	<p>Ky program studimi i ofruar nga Departamenti i Finance Kontabilitetit (DFK) si njësi bazë, ka në fokus fushën e gjerë të financës dhe kontabilitetit. Këto fusha përkojnë me veprimtarinë e Fakultetit të Ekonomisë si njësi kryesore dhe DFK si njësi baze.</p> <p>Programi nuk është kodifikuar në zbatim të VKM.nr.310 date 11.05.2022” Nga ana tjetër USH me shkresën nr.196/1 prot, date 23.03,2023 drejtuar MAS ka bere propozimet përkatëse për kodifikimin e programeve që zhvillohen dhe është në pritje</p>

programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	të vendimit përfundimtar për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit <i>Referenca:</i> <i>Strategjia e mësimdhënies 2017-2022 dhe 2022-2026</i> <i>Kodifikimi i programit FK. Kërkesa</i>								
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet është në përputhje me misionin dhe qëllimin e veprimtarisë të USH duke ruajtur interesat dhe vlerat kombëtare dhe në përputhje me fushën akademike e kerkimore të njësisë kryesore dhe asaj baze..</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Hartimi i programit Bachelor në FK është paraprirë nga diskutimi dhe konsultimi në njësinë kryesore (FE) dhe atë baze (DFK) që në periudhën e kërkesës për hapjen e këtij programi si dhe me strukturat e tjera të institucionit dhe informacionin marre nga aktorë të tregut të punës duke evidentuar argumentet e hapjes që në vitin 2010. Miratimi i programit është fryt i bashkëpunimit të strukturave brenda USH dhe ndarja e detyrave dhe përgjegjësive mes njësive kryesore, njësive baze dhe gjithë strukturave mbështetëse të programit janë të sanksionuar në një sere aktesh rregullative dhe mbikëqyrëse si rregullore e studimeve në USH, rregullore e Fe dhe rregullore e DFK. Në këto dokumente janë të përcaktuar qarte drejtimit e bashkëpunimit dhe ndarja e përgjegjësive të gjitha njësive përkatëse. Me marrjen e licencimit nga MAS njësia baze dhe kryesore e UB kane marre gjithë përgjegjësinë e zhvillimit të programit të studimit duke analizuar dhe evidentuar edhe ecurinë e programit . <i>Referenca:</i> <i>Rregullore e studimeve në USH</i>

	<p><i>Rregullore e FE</i></p> <p><i>Rregullore e DFK</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e aplikimit të institucionit shohim se USH gjate viteve të fundit ka qene mjaft aktiv duke nënshkruar rreth 50 marrëveshje apo memorandum bashkëpunimi me institucione homologe, brenda dhe jashtë vendit si dhe aktore të biznesit, institucione publike etj. Këto marrëveshje janë në funksion të realizimit të objektivave të procesit mësimor dhe lidhen si me angazhimin e specialisteve të këtyre organizatave në ofrimin e eksperiencës ashtu edhe në mundësinë e realizimit nga studentet të praktikës mësimore pranë tyre në funksion të këtij program janë rreth 10 marrëveshje bashkëpunimi kryesisht për realizimin e praktikës profesionale.</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit në nivel universiteti</i></p> <p><i>Marrëveshjet e bashkëpunimit në nivel universiteti</i></p> <p><i>Aneks tabelash (tabela nr.5)</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Bazuar në listën e marrëveshjeve të bashkëpunimit mes UB dhe institucioneve të tjera apo aktoreve të sipërmarrjes shikojmë se një numër i konsiderueshëm e tyre ofrojnë mundësinë e realizimit të praktikave profesionale për studentet e këtij program. Ky numër marrëveshjesh plotëson edhe qëllimin e realizimit të praktikës profesionale të studenteve të këtij programi.</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit në nivel universiteti</i></p> <p><i>Marrëveshjet e bashkëpunimit në nivel universiteti</i></p> <p><i>Aneks tabelash (tabela nr.5)</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit paraqitur për aplikim pranë ASCAL-it si dhe nga takimi në institucion rezulton se DFK analizon dhe shqyrton në raportet periodike edhe ecurinë dhe realizimin e marrëveshjeve në funksion të programit si nëpërmjet kontakteve me partnerë ashtu edhe në takime të specialisteve të këtyre të fundit me stafin dhe studentet.</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Raporti i analizës se punës shkencore në FE</i></p> <p><i>Raporti i analizës se punës shkencore në DFK</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i</i></p>

	studimit Bachelor në FK bazohet në një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi mes USH dhe homologeve të tij, institucioneve apo sipërmarrjeve të ndryshme duke mundësuar realizimin e praktikës profesionale dhe marrjen e eksperiencës nga specialiste të fushës jashtë USH.		
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënljore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Bachelor në "FK "që ofrohet nga DFK i Fakultetit të Ekonomisë pranë USH është i organizuar në 22 lëndë (përfshire praktiken profesionale) dhe 34 module të cilat vlerësohen me kredite përkatëse në përputhje me VKM Nr. 41, datë 21.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, ku lëndët e modulet vlerësohen me sistemin e krediteve ECTS dhe orë. Programi bazohet në Sistemin Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS) dhe parimeve të Kartës së Bolonjes. Programi me një kohëzgjatje 3 vite akademike e ndarë në 6 semestra dhe që përfshin 180 ECTS. <u>Referenca:</u> <i>Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Aneks tabelash (tabela nr. 10)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale	Duke shqyrtuar programin mësimor si dhe përmbajtjen e syllabuseve konstatohet që arrihet të transmetohen njohuri të fushës së financës dhe kontabilitetit. Kjo bën të mundur që studentët që përfundojnë këtë program mund të punësohen si

e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.

specialistë në finance apo kontabilitet brenda hapësirës së njohurive të një programi Bachelor si dhe të mund të vazhdojnë programin e ciklit të dytë në profilet e këtij programi pas diplomimit të tyre. Plani mësimor është i qartë dhe në të janë të paraqitura lëndët/ modulet me gjithë ngarkesën e tyre në mënyrë që të përmbushen më mirë objektivat e mesimnxenies nga ana e studentëve do të sugjerohet disa rregullime kryesisht teknike që nuk prekin përmbajtjen e programit të propozuar. Kështu:

1. Bazuar në fushën e programit me fokus financën dhe kontabilitetit në vitin e parë semestri i II-te mund të përfshihet lënda "*Matematika Financiare*". Studentet tashme kanë marrë në semestrin e I-re njohuritë e përgjithshme në matematikë dhe në semestrin e II fokusohen tek matematika financiare që tashme është e rëndësishme në kuadrin e aplikimeve në finance;
2. Në program të mund të zinin me shume peshe njohuritë në *finance dhe kontabilitet* në funksion të këtij qëllimi mund të bëhen edhe rregullime si më poshtë vijon:
 - Lënda *kontabilitet i kostos dhe drejtim* të ndahej në dy module me emërtimet përkatëse; *Kontabilitet Kosto dhe Kontabilitet Drejtimi*. Në vend të lendes HSHM e cila të mos ketë dy module por vetëm *Drejtimin e operacional*. Studenti në vitin e parë ka marrë njohuritë baze të menaxhimit me lenden me këtë emërtim;
 - Lënda "*Drejtim Investimesh dhe Finance Ndërkombëtare*" që ka dy module sipas emërtimeve të mësipërme të reduktuohet në një në lenden *Investime*". Kjo pasi moduli *Financa Ndërkombëtare*" për vete specifikën dhe nivelin e vështirësisë mund të zhvillohet në ciklin e dytë të studimeve të nivelit Master;
 - Bazuar në rëndësinë e lendeve me zgjedhje që i krijojnë mundësi studentit të "profilizohet" me shume në *finance dhe kontabilitet* apo edhe të rrisë njohuritë në fushën e ekonomisë do ishte me mire që të redukttoheshin disa lende kryesisht të gjuhës se huaj si, *Turqisht, Gjuha Malazeze; Kulture gjuhe*, dhe të përfshiheshin lende të tilla si "*E-banking dhe financa; E-marketingu, e-biznesi*" *Shkrimi akademik dhe komunikimi në biznes* " të cilat krahas lendeve të tjera me zgjedhje do plotësonin me mire përmbajtjen e programit;

Referenca:

Plani mësimor i programit të studimit

	<i>Aneks tabelash; Tabela nr. 10</i>
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	<p>Mbështetur në pasqyrën e hartuar nga institucioni “Plani mësimor i ndare sipas veprimtarive formuese” evidentojmë se organizimi i kurrikulës respekton kriteret e përcaktuara në VKM nr 41, date 25.01.2018 sipas tipit të veprimtarisë nga A tek E si më poshtë:</p> <p>Lëndët e kategorisë A zënë 18 % të numrit të krediteve ndaj nivelit maksimal prej 20 % që është kriteri;</p> <p>Lëndët e kategorisë B zënë 52 %; të numrit të krediteve ndaj nivelit maksimal prej 55 % që është kriteri;</p> <p>Lëndët e kategorisë C zënë 15. %; të numrit të krediteve ndaj nivelit maksimal prej 15 % që është kriteri;</p> <p>Lëndët e kategorisë D zënë 10.5 %; të numrit të krediteve ndaj nivelit maksimal prej 15 % që është kriteri;</p> <p>Lëndët e kategorisë E zënë 3.3 %; të numrit të krediteve ndaj nivelit maksimal prej 5 % që është kriteri;</p> <p>Bazuar në kriteret e miratuara për një program Bahelor shohim se struktura e programit përmbush kriteret e vendosura.</p> <p><i>Megjithatë GVJ mendon se lënda e “Marketingut” nuk përkon me natyrën e lendeve të kategorisë A pasi nuk është e natyrës së përgatitjes metodologjike dhe kulture të përgjithshëm.</i></p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Plani mësimor i programit të studimit</i></p> <p><i>Aneks tabelash; Tabela nr. 10</i></p>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblyëse.	<p>Programi i studimit është mbështetur në plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore përfshin si komponent me vete praktiken profesionale e cila zhvillohet menjëherë pas përfundimit të procesit mësimor dhe përpara diplomimit të studenteve. Praktika profesionale në planin mësimor është e planifikuar me 250 ore totale dhe me 10 kredite (sistemi ETCS)</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Plani mësimor i programit të studimit</i></p> <p><i>Aneks tabelash; Tabela nr. 9</i></p>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimit të studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në	<p>Institucioni mbështetur në kërkesat dhe kriteret ligjore dhe nënligjore në fuqi ka hartuar “Rregullorja e Studimeve në USH” nr.182, date 28.06.2016. Në këtë dokument janë të përcaktuara procedurat dhe fazat e procesit të pranimit vlerësimit, transferimit dhe financimit të studenteve. Në këtë</p>

<p>përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>program nuk ka pasur praktike pranimi dhe financimi të studenteve me status të veçante.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>"Rregullorja e Studimeve në USH"</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>USH ofron vetëm këtë program studimi në Bachelor në FK. Nga informacioni që GVJ ka rezulton se programi Bachelor me këtë emërtim në institucionet e tjera të arsimit të lartë në Shqipëri zhvillohen në disa prej tyre. Përmbajtja e programit duke marre për bazë fushën e financës dhe kontabilitetit në kuadër të gjere përmban në pjesën me të madhe lende që zhvillohen në programe të ngjashme Bachelor brenda dhe jashtë vendit (mbi 70 % e programit është e njëjtë).</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Aneks tabelash; Tabela nr. 10</i></p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi është në proces kodifikimi në kuadër të zbatimit të VKM nr.310 date 11.05.2022" Ashtu siç e kemi theksuar me lart USH ka bere kërkesën për kodifikim të një numri programesh që zhvillohen pranë MASR këtë vit kalendarik dhe është në pritje të vendimit.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Kodifikimi i programit FK. kërkesa</i> <i>Referuar takimeve në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Programi Bachelor në FK, aktualisht nuk është një program i përbashkët me ndonjë institucion tjetër të arsimit të lartë vendas apo të huaj.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit Bachelor në FK organizohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në strukturë dhe përmbajtje. Megjithatë në funksion të përmirësimit të tij sugjerimet e GVJ në kriterin nr.2 dhe 3 të këtij standardi do i shërbenin këtij procesi.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																				
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>FE si njësia kryesore e këtij program studimi përmbush detyrimet ligjore në organizim, strukturë dhe staf akademik. Kjo njësi përbehet nga tre Departamente që aktualisht zhvillojnë 12 programe studimi të nivelit Bachelor dhe Master:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Departamentin e Administrim Biznesit; - Departamentin e Financës; - Departamentin e Turizmit; <p>Stafi akademik sipas departamenteve për vitin akademik 2020-2021 është si më poshtë vijon:</p> <p><u>Departamenti i Administrim Biznesit:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 10 PAE, ndër të cilët 8 me tituj / grada; - 19 PAK, ndër të cilët, 3 me tituj / grada; <p><u>Departamenti i Financë:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 12 PAE, ndër të cilët 11 me tituj / grada; - 12 PAK, ndër të cilët 3 me tituj / grada; <p><u>Departamenti i Turizmit:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 9 PAE, ndër të cilët 7 me tituj / grada; - 8 PAK, ndër të cilët 0 me tituj / grada; <p>DFK si njësi baze që mbulon këtë program studimi i plotëson kriteret ligjore të përcaktuara. Njësia bazë, Departamenti i Financë Kontabilitetit përgjegjës për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë për vitet akademike:</p> <table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/ grada</th> <th colspan="2">2020-2021</th> <th colspan="2">2021-2022</th> <th colspan="2">2022-2023</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr.</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>-</td> </tr> </tbody> </table>	Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	2	-	2	-	2	-
Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023																
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK															
Prof.Dr.	2	-	2	-	2	-															

	Prof. Asoc.	3	-	3	-	3	-
	Dr./PhD.	6	3	6	3	6	3
	Msc.	1	9	1	13	1	8
	Totali	12	12	12	16	12	11
	<p>DFK ka në strukturën e tij edhe 2 laborante si staf ndihmës akademik. Shihet se DFK plotëson kërkesat ligjore në fuqi lidhur me strukturën akademike të stafit.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Organigrama e re e FE</i> <i>Aneks tabelash ; Tabela nr.1 dhe 3</i> <i>PAE-PAK te dhena per programet FE</i></p>						
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Realizimi i praktikave profesionale bazohet në marrëveshjet që FE apo USH ka me institucione apo sipërmarrje të ndryshme duke angazhuar në këtë proces edhe PAE me planifikim ngarkese mësimore për ta.</p> <p>DFK ka në strukturën e tij edhe 2 laborante si staf ndihmës akademik. Gjithashtu, koordinatori i programit është edhe personi përgjegjës për ndjekjen e praktikave profesionale të studenteve</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Aneks tabelash ; Tabela nr.1 dhe 3</i></p>						
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Me vendim nr.1109 date 14.10 2020 DFK ka miratuar koordinatorin e këtij programi Dr. K. H. që asiston përgjegjës in e departamentit në mbikëqyrjen e ecurisë se program të studimit. Gjithashtu, koordinatori i programit organizon edhe praktikat profesionale të studenteve.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Vendimi mbi koordinatorin e programit</i></p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se njësia kryesore FE dhe njësia baze DFK të program të studimit</i></p>						

	<i>Bachelor në FK plotësojnë kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të prezantuar nga FE si njësi kryesore dhe DFK si njësi baze si dhe nga verifikimi gjatë vizitës në institucion, rezulton se këto njësi disponojnë informacionin e nevojshëm mbi organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit dhe jo vetëm si evidencë, por dhe janë të aksesueshme nga gjithë stafi akademik. Ky informacion përfshin të dhëna të plota të programit si dhe gjithë bazën rregullative në nivel institucioni, fakulteti departamenti dhe programi. Ky informacion është i aksesueshem edhe nga studentet e programit nëpërmjet platformës ESSE3. Gjithashtu USH në baze të marrëveshjes me RASH aplikon platformën PITAGORA që jep mundësi aksesit në informacione e procesit mësimor për stafin dhe studentet</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Platforma Pitagora</i> <i>Verifikim gjatë vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit të studimit vërehet se ai jep të gjithë informacionin e nevojshëm me elementet përkatës të tij si ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë tij, ndjekjen e programit (me kohë të plotë) si dhe vlerësimin e dijeve. Në mbështetje të programit janë edhe rregulloret përkatëse në nivel institucioni fakulteti departamenti si dhe të vete programit. Po ashtu në rregullore të veçanta jepen modalitetet dhe kriteret e regjistrimit të studenteve potencial në këtë program si dhe transferimet nga jashtë apo brenda të studimeve në këtë program.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Rregullore e programit të studimit Bachelor në FK</i></p>

<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Institucioni bazuar në kuadrin ligjor dhe nënligjor ka hartuar bazën rregullatorë lidhur me procesin përcaktimit të kriterëve të përgjithshme apo specifike lidhur me pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve apo studenteve. në funksion të këtij procesi është rregullorja e studimeve të USH dhe rregulloret e tjera në nivel njësie kryesore (FE) dhe njësie baze (DFK). Gjate vizitës në institucion pranë zyrës së sekretarisë mësimore GVJ evidentoi raste transferimi student i bazuar në procedurat e miratuara.</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Rregullorja e studimeve në USH</i></p> <p><i>Rregulloret e programit të studimit Bachelor në FK</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit të studimit rezulton se ai përfshin gjithë elementët përbërës formues teorik praktik për një program të nivelit Bachelor. Nga shqyrtimi i syllabuseve vërejmë se ato hartohen në gjuhë shqipe dhe përmbajnë të gjithë elementët e përcaktuara në Vendimin e KM Nr.41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, si :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Emërtimi i lëndës/ modulit; • Viti/ semestri kur zhvillohet lënda; • Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën; • Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit; • Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetimin e lëndës; • Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë; • Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik; • Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS; • Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre; • Format e vlerësimit të studentëve; • Detyrimet e studentit për lëndën; • Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse; <p>GVJ vlerësoi cilësinë e syllabuseve të programit të prezantuar në kuadër të këtij vlerësimi. Hartimi i syllabuseve të programit përfshin të gjitha elementët e nevojshëm duke plotësuar kriteret për to. Format e mësimdhënies janë nëpërmjet vlerësimit</p>

	<p>periodik në seminare (për pjesëmarrje aktive), detyra kursi, provime të ndërmjetme dhe provim final.</p> <p>Nga shqyrtimi i elementeve të syllabusve u konstatuan mangësitë si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Në disa prej tyre literatura e rekomanduar nuk është viteve të fundit, por i referohet viteve 2005-2010; ➤ Në trajtimin e temave që do të zhvillohen nuk jepet literatura baze dhe ndihmese për këto tema të cilat do ndihmonin studentin gjate zhvillimit të seminareve; ➤ Në një numër të konsiderueshëm të programeve vlerësimi gjate vitit nëpërmjet formave të kontrollit të dijes (seminare, detyra kursi etj) zë një peshe të ulet ndërkohë që provimi përfundimtar zë 70%,80% apo edhe në disa raste 90% të pikëve; ➤ Syllabuset e lendeve të gjuhëve të huaja janë të ndërtuar pjesërisht në shqip dhe pjesërisht në anglisht, në një kohe kur kërkesa është në shqip ashtu siç edhe ofrohet programi; <p><u>Referenca:</u> Syllabuset e programit</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik që mbulon këtë program si dhe me stafin e DESF u evidentua diskutimi dhe axhustimi programit në mënyre periodike në fillim të vitit brenda lirisë akademike si dhe futjen e informacioneve të reja të njohurive përkatës. Nga ana tjetër, ndryshimet me të fundit në program lidhur me lendet e përfshira janë bere që në vitin 2018 dhe që konsistojnë në ndryshime strukturore pa prekur brendinë e programit.</p> <p><i>GVJ mendon që zhvillimet e 4-5 viteve të fundit në ekonomi e bëjnë të domosdoshme përmirësimin e programit në funksion të këtyre ndryshimeve ku me vlere janë edhe rekomandimet tone të dhëna me sipër.</i></p> <p><u>Referenca:</u> Vizita ne Institucion</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit Bachelor në FK është i detajuar me të gjithë elementet përkatës, si dhe i strukturuar dhe organizuar për të plotësuar objektivat formues të tij. Përmbajtja e lendeve /moduleve të programit përgjithësisht janë me të gjithë elementet përkatës por edhe në përmbajtjen e tyre.</i></p>

	<u>Mendojmë që në një pjese të programeve të reflektohen katër mangësitë e vërejtura në kriterin 4 nga GVJ gjate shqyrtimit të tyre si dhe të shihet mundësia e përmirësimeve në përmbajtjen e tij.</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	<p>Programi në emërtim dhe përmbajtjen e tij ofron tiparet e një program studimi të nivelit Bachelor në fushën e financës dhe kontabilitetit. Programi synon të kombinojë njohuritë teorike në këtë fushë me ato praktike. Këtë e shikojmë në përmbajtjen e lëndëve të programit si dhe në realizimin e praktikës profesionale me mundësi punësimi në treg. Emërtimi dhe përmbajtja jo vetëm u mundëson punësimin në përfundim të studimeve në finance apo kontabilitet por të diplomuarit në këtë program mund të vazhdojnë ciklin e dyte të studimeve Master në një spektër me të gjere të financës, kontabilitetit dhe auditimit.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Rregullore e programit të studimit Bachelor në FK</i></p>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	<p>Programi arrin të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme në të katër drejtimet e tij. Duke analizuar programin shohim që studentet</p> <ul style="list-style-type: none"> - në vitin e pare marrin njohuritë baze makro dhe mikroekonomike, matematike, statistike dhe konceptet në financë të domosdoshme për çdo program të fushës se ekonomisë; - në vitin dyte në disa nga lendet që zhvillohen merren njohuri të menaxhimit por edhe të fushave baze të sigurimeve pasurive të paluajtshme etj; - në vitin e trete programi ofron njohuri me specifike lidhur me financën, bankave, pasuritë e paluajtshme et

	<p>të cilat krahas praktikës profesionale finalizohen me detyrimet përmbyllëse;</p> <p>Mbështetur në lëndët që ofron programi, por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teorik shkencor dhe relativisht edhe atë aplikativ të studentëve.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Programi në hartimin dhe zhvillimin e tij bazohet në eksperiencë të gjatë të DFK. Mbështetur në strukturën e programit, në lëndët që përfshihen në të, raportet teorike praktike, ky program përputhet me fushën e zgjedhur që është ajo financiare dhe kontabile. Në të arrihet të trajtohen elementët e nevojshëm që lehtësojnë njohjen dhe ekuivalentimin e diplomës jashtë vendit, për qëllim vazhdimin e studimeve në ciklin e dyte apo punësimin e studentit. Programi i studimit është në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arrijtjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit harmonizon përmbajtjen teorike me atë praktike. Nga shqyrtimi i syllabusve të lendeve karakterizuese të programit shohim që në to një pjesë e temave u referohen rasteve studimore apo praktikave laboratorike. Përmbajtja e tyre është e bazuar në përmbajtjen e lendeve të tilla edhe në universitetet e huaja duke mundësuar ekuivalentimin në rast transferim studimi</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke</p>	<p>Nga shqyrtimi i përmbajtjes të lendeve të këtij program të prezantuar nga institucione vërejmë se në pjesën me të madhe të tyre ka përditësim të njohurive bazuar në literature detyruese dhe ndihmese të botuar gjatë viteve të fundit. Edhe nga takimi me stafin e DFK gjatë vizitës në institucion në evidenciam përditësimin e leksioneve të përgatitura nga stafi akademik. Megjithatë në disa nga programet e lendeve të përmendura me</p>

përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Iart ka nevojë që literatura e rekomanduar të jetë e viteve të fundit. <i>Referenca:</i> <i>Syllabuset e programit</i>			
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programeve realizon përfitimet e dijeve dhe aftësive të studenteve për një program bachelor në FK. Programi i studimit përfshin trajtimin fillimisht të lendeve baze me formim mikro dhe makroekonomik dhe që në vitin e parë përfshihen lendet e përgjithshme në fushën e financës dhe kontabilitetit për tu pasuar në vitet e tjera me lende kryesisht profesionale në fushën e programit. Programi i studimit kombinon si trajtimin teorik ashtu edhe atë aplikativ sidomos në lendet e financës. <i>Referenca:</i> <i>Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Rregullore e programit të studimit</i>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit është mbështetur në eksperiencën e programeve të tilla kombëtare, por edhe në ato ndërkombëtare. Përmbajtja e programit është e tillë që nëpërmjet njohurive të marra në të katër drejtime e ti të beje të mundur për studentet e diplomuar vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë të programit Master. Gjithashtu, ky program u mundëson hyrjen në tregun e punës të studentëve në katër drejtimet e tij. Specifikimi që në emërtim i këtyre katër drejtimeve është përparësi në mundësinë e punësimit të të diplomuarve dhe kjo sidomos në tregun imobilar. <i>Referenca:</i> <i>Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Rregullore e programit të studimit</i>			
Konkluzione	GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit Bachelor në FK përmbush objektivat formuese të tij dhe nivelin kualifikues sipas Kuadrit Kombëtar dhe European të Kualifikimeve duke mundësuar studentet e diplomuar për tu punësuar në tregun financiar dhe me gjerë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>DFK si njësi baze dhe përgjegjëse e këtij program bazuar në marrëveshjet institucionale me aktoret e tregut të punës bën përpjekje në përmirësimin e programeve ku ajo është përgjegjëse drejtpërdrejt. Lidhur me këtë program në evidentuam përmirësimet në program kane qene kryesisht në kuadrin e lirisë akademike të stafit. Nga diskutimi me stafin akademik që zhvillon këtë program evidentuam përmirësim në ciklet e leksioneve të lendeve që ata mbulojnë kryesisht me trajtime aplikative të lidhura me tregun financiar dhe pasuritë e paluajtshme. Institucioni ka hartuar strategjinë e tregut të punës për vitet 2017-2022 dhe strategjinë e tregut të punës për vitet 2022-2026. Gjithashtu, edhe FE ka bere studim tregu të punës deri në vitin 2022.</p> <p><i><u>Nga shqyrtimi i këtyre strategjive dhe studimit vërejmë se ato janë të përgjithshme dhe nuk kane evidenca referuese në ndihme të punësimeve të te diplomuarve në të ardhmen. Gjithashtu, nuk ka analize tregu pune për studentet e diplomuar në këtë program në rang lokal apo kombëtar.</u></i></p> <p><u>Referenca:</u> <i>Strategjia e tregut të punës 2017-2022 dhe 2022-2026. Studim treg pune 2017-2022 Vizita në institucion dhe takim me stafin akademik</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Diskutimi dhe opinion i studenteve rreth programit mësimor dhe mësimdhënies realizohet nëpërmjet diskutimeve me pedagogun e lendes por edhe nëpërmjet instrumentit të vlerësimit nëpërmjet anketimeve që ruajnë anonimitetin e tyre që ata bëjnë për lenden dhe pedagogun përkatës. Institucioni mban kontakte me studentet e diplomuar ku Zyra e Karrierës dhe Alumni përgjegjëse për këtë lidhje kontaktojnë me të diplomuarit. Edhe Këshillat studentore të zgjedhura janë pjese e këtij procesi.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Rregullore e Këshillave të studenteve Raport nga Zyra e Karrierës dhe Alumnit</i></p>

<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Te dy studimet e tregut të punës në nivel institucional dhe atë të njësisë kryesore janë një ndihmese për përmirësimin e programit. Megjithatë duhet theksuar se këto studime janë të përgjithshme, kryesisht në rang kombëtar dhe jo me fokus tregun potencial të punës për studentet që diplomohen në këtë program studimi. FE ka organizuar disa panaiere pune që ndihmojnë në punësimin e të diplomuarve. Përmirësimet e fundit në program janë bere që në vitin 2018 të cilat kane qene të karakterit teknik dhe jo në përmbajtje.</p> <p><u>Një analize me e thelluar e tregut të punës lidhur me këtë program do të beje që edhe ndryshimet e mundshme në të jene të karakterit të përmbajtjes dhe rritjes se cilësisë në funksion të tregut të punës.</u></p> <p><u>Referenca:</u> Studim treg pune 2017-2022 Panairi i punës Marrëveshje me KKK</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><u>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se përfshirja e studenteve në procesin e përmirësimit dhe vlerësimit të programit plotëson standardet e kërkuara duke qene premise në përmirësimin e tij në të ardhmen. <u>GVJ sugjeron që të realizohet një studim i plote i tregut të punës me fokus tregun potencial për tu punësuar në sektorët e finance, bankës, sistemit tatimor e doganor dhe kontabilitete.</u></u></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1




Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Mësimdhënia në programin Bachelor në “FK” bazohet në kuadrin rregullator në nivel institucional, njësie kryesore dhe njësie baze në funksion të këtij procesi janë përkatësisht rregullorja e studimeve në USH; rregullorja e FE, rregullorja e DFK dhe vete rregullorja e programit të studimit Bachelor në FK në të cilat përcakton format e mësimdhënies dhe vlerësimin e dijeve të studentëve. Procesi mësimor zhvillohet nëpërmjet formave të mirënjohura: leksione, seminare, detyra kursi, ushtrime, praktika profesionale etj, të organizuara në 22 lënde nga të cilat 19 janë të detyrueshme dhe 34 module, ku janë parashikuar teste të ndërmjetme, detyra kursi, provim përfundimtar dhe tema e diplomës. në program nga 9 lende me zgjedhje studentet do zgjedhin 3 prej tyre. në planin mësimor orët mësimore në auditor dhe jashtë auditorit si angazhim individual i studentit janë të përcaktuar sipas të gjitha elementeve të një programi të nivelit Bachelor. Në këtë program lëndët zhvillohen sipas syllabusit përkatës dhe në liri të plotë të personelit akademik. Për të ruajtur objektivitetin e vlerësimit forma e kontrollit në program është me shkrim dhe e sekretuar. Në politikën e Institucionit është praktikë që nota e studentit të jetë e “ndërtuar”, që do të thotë që studenti testohet gjatë semestrit në secilën lëndë përveç provimit përfundimtar në sezon. Shumatorja e pikëve të mbledhura përbën vlerësimin e tij përfundimtar. Forma e vlerësimit referuar ECTS përcaktohen me notë (1 deri 10) dhe ekuivalentin e notave nga F në A. Ky sistem vlerësimi përfshin 100 pikë, të cilat përgjithësisht janë të ndara në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • frekuentimi dhe vlerësimi gjatë semestrit; • testi i ndërmjetëm apo detyra e kursit që zhvillohet në mes të semestrit; • provimi përfundimtar që zhvillohet në fund të semestrit; <p>Mënyra e vlerësimit të studentëve është prezantuar në syllabusin e çdo lënde.</p> <p><u><i>Siç e kemi theksuar edhe me lart format e vlerësimit gjate vitit e përcaktuar në syllabus për një numër të konsiderueshëm të programeve të lendeve është në nivele të ulta, gje që duhet përmirësuar në të ardhmen.</i></u></p>

	<p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Plani mësimor i programit të studimit</i></p> <p><i>Rregullorja e studimeve në USH</i></p> <p><i>Rregullore e Fakulteti të Ekonomisë</i></p> <p><i>Rregullore e programit të DFK</i></p> <p><i>Rregullore e programit të studimit Bachelor në FK</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik që mbulon këtë program ka aftësitë pedagogjike bashkëkohore në mësimdhënie rrjedhojë kjo edhe e eksperiencës relativisht të gjatë në procesin e mësimdhënies. Pozitive është fakti që PAE i DFE ka qene i qëndrueshëm gjate tre viteve të fundit (12 PAE). Nga ana tjetër, nga takimi me studentët e këtij programi, GVJ evidentoi faktin e marrjes se mendimit të studenteve lidhur me përmirësimin e procesit të mësimdhënies për të kryer më shumë seanca seminare praktike të mësimnxënies nga studentët.</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Bazuar në takimin me stafin e DFK rezultoi se USH mbështet stafin akademik në përmirësimin e metodës pedagogjike kryesisht nëpërmjet vizitave pranë universiteteve homologe të huaja, si dhe mobiliteteve në kuadër të projektit ERASMUS+. Bazuar në faktin se USH ka qene mjaft aktiv si pjesëmarrës në disa projekte të ERASMUS + është arritur të realizohen një numër i kënaqshëm mobilitete të stafit akademik (shih tabelat e raportit mbi mobilitetet e stafi në FE per periudhën 2017-20 dhe 2020-2023). Ne vitin 2019 në FE janë realizuar dy takime me eksperte të fushës apo trajnues në fushën e pedagogjisë.</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Mobilitetet e stafit në FE per vitet 2017-2020 dhe 2020-2023</i></p> <p><i>Trajnime mbi metodat bashkëkohore të mësimdhënies.</i></p> <p><i>Takimet e organizuara gjate vizitës në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit të</p>	<p>Personeli akademik që mbulon këtë program ka eksperiencën dhe kualifikimin e duhur për një proces mësimdhënie të suksesshëm. Bazuar në CV-të e stafit akademik, vëmë re që pothuajse të gjithë kanë një formim akademik dhe profesional në fushën e Financës kontabilitetit dhe menaxhimit në përputhje me lëndët që karakterizojnë drejtimit përkatëse. Nga takimi me studentët e programit u evidentua një bashkëpunim reciprok i frytshëm mes tyre dhe personelit akademik. Është praktike e procesit mësimor që në fund të zhvillimit të lendes</p>

<p>student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>si dhe para se vlerësimi i lendes të gjenerohet në sistem realizohet një takim mes pedagogut dhe studenteve.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>CV stafi akademik</i> <i>Aneks tabelash; Tabela nr.4 dhe 12</i> <i>Takimet e organizuara gjate vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>DFK si një njësi baze e konsoliduar luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e programit të studimit. Nga ana tjetër është bere e mundur përfshirja e studenteve në vlerësimin e mësimdhënies dhe stafit akademik. Krahas përvojës mësimdhënëse që stafi i programit ka marre nëpërmjet mobiliteteve të programit ERASMUS + në USH janë realizuar edhe trajnime pedagogjike me stafin e ri akademik.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Trajnim mbi metodat bashkëkohore të mësimdhënies</i> <i>Raporti i aktivitetit të DFK</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe</p>	<p>USH krahas akteve rregullatore në funksion të procesit mësimor shkencor (Rregullorja e studimeve në USH) ka miratuar Komisionin e Garantimit të Standardeve të Cilësisë (KGSC) si njësi përgjegjëse në nivel institucional që promovon përmirësimin e mësimdhënies në kuadër të përmirësimit të cilësisë. Me vendim të Senatit të USH Nr.92, date 13.04.2022 është miratuar edhe manuali i cilësisë në të cilin në nenin 9 sanksionohet ngritja e Njësisë se Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Anëtarë të NJSBC janë përfaqësues nga çdo departament.</p> <p>NJSBC funksionon në baze të rregullores përkatëse të saj. Në këtë rregullore sanksionohen funksionet dhe mënyra e operimit të kësaj njësie. Gjithashtu në nivel institucional funksionon edhe Zyra e Sigurimit të Cilësisë dhe Standardeve që në bashkëpunim me NJSBC koordinon punën lidhur me funksionin e kësaj njësisë.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur pran ASCAL-it në evidentuam një relacion në forme raporti mbi analizën e pyetësorëve me studentet e programit Bachelor në FK realizuar në semestrin e II- të vitit akademik 2021-2022. në të behet analiza e vlerësimit të studenteve për procesin mësimor. Strukturat/ njësitë e ngritura në nivel institucional kane një</p>

zbatimit të metodave të reja.	<p>historik relativisht të shkurtër dhe si rrjedhojë kane realizuar vetëm vlerësimin me anën e anketimeve të studenteve.</p> <p><u>Referenca:</u> Rregullore e NJSB Manuali i cilësisë Rregullore e KGSC Analiza e pyetësorëve të studenteve për programin Bachelor në FK Trajnim mbi metodat bashkëkohore të mësimdhënies</p>											
Konkluzione	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se USH realizon në procesin e mësimor gjithë elementet e duhur të ndara në leksione ,seminare ,projekte e detyra kursi, praktike profesionale etj. Institucioni në përmbushje të akteve ligjore dhe nënligjore ka ngritur strukturat përkatëse që promovojnë vlerësojnë dhe mbikëqyrin përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Eksperiencia e shkurtër e ngritjes se këtyre njësive /strukturave në nivel institucional ka mundur të realizojë vlerësimin nga studentet të procesit mësimor dhe stafit akademik</p>											
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X			
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht									
			X									

Standardi III.2	
Institucioni barton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloret e posaçme, të cilat janë pjesë zbatuese si në nivelin institucional njësie kryesore, baze ashtu edhe për programin e studimit. Në rregulloren e studimeve të USH janë të përcaktuara parimet dhe kriteret kryesore të vlerësimit të dijeve. Kështu në Kreun 4 të Rregullores se USH, përcaktohet se "kontrolli i dijeve " në nenin 22 të kësaj rregulloreje përcaktohet kufiri 20 deri 40 % të kontrollit të dijeve gjate procesit të zhvillimit të lendes. një prag i ulet po të kemi parasysh se vlerësimi i vazhdueshëm gjate vitit duhet të këtë me shume pjese.</p>

	<p>Me të detajuara kriteret dhe mënyra e vlerësimit të njohurive përcaktohen në rregulloren e këtij programi studimi si dhe në programin e çdo lende (syllabusin) në pjesën e vlerësimit. Këto dokument janë aksesueshme si nga stafi akademik edhe nga studentet.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Rregullorja e studimeve në USH</i> <i>Rregullore e Fakulteti të Ekonomise</i> <i>Rregullore e DFK</i> <i>Rregullore e programit të studimit Bachelor në FK</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e ofruar dhe vizitën në institucion, GVJ evidenton se studentët e programit informohen mbi mënyrën e vlerësimit të njohurive nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Informacionit të marrë në webin e institucionit pasi rregulloret në këtë drejtim janë të përfshira në te; • Informacionit që marrin që në fillim të semestrit përkatës nëpërmjet syllabuseve të lëndëve përkatëse të pedagogëve përgjegjës për zhvillimin e tyre; <p>Pedagogu i lendes në fillim të zhvillimit semestrit sqaron dhe informon studentet për kohën dhe elementet e vlerësimit të vazhduar dhe atë përfundimtar.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Syllabuset e programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Takim me stafin akademik dhe studentet e programit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet në format tashmë të konsoliduar dhe përfshijnë elementë të vlerësimit të vazhdueshëm në seminar, testimin e ndërmjetëm, detyrat e kursit, provimin përfundimtar etj, elementë këto që u evidentuan gjate shqyrtimit të programeve të lendeve si dhe takimit me stafin akademik dhe studentet e programit të studimit.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Syllabuset e programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Rregullorja e programit Bachelor në FK</i> <i>Takim me stafin akademik dhe studentet e programit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë</p>	<p>Mendimi i studenteve për cilësinë e mësimdhënies dhe vlerësimi i tyre për performance e pedagogut realizohet nëpërmjet organizimit nga Zyra e Sigurimit të Standardeve dhe Vlerësimit në bashkëpunim me NJSBC nëpërmjet anketimit. Ky anketim realizohet në fund të çdo semestri. Raporti i</p>

<p>periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>rezultateve të dala hartohet nga kjo njësi dhe analizohet në DFK si njësi baze e këtij program studimi. Me vendim të Senatit nr.4133 date 19,12.2022 është miratuar edhe paketa e matjes se cilësisë në të cilën janë specifikuar modelet e anketimit për studentet, si dhe të vlerësimit të performanes se stafit akademik dhe vlerësimi tij nga studentet dhe drejtuesit e njësisë përkatëse.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Rregullore e NJSB</i> <i>Manuali i cilësisë</i> <i>Rregullore e KGSC</i> <i>Analiza e pyetësorëve të studenteve për programin Bachelor në FK</i> <i>Paketa e matjes se cilësisë</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik dhe studentet e programit u evidentua që realizimi i procesit mësimor nëpërmjet metodave të mirënjohura kombinohet me një qasje interaktive mes tyre duke nxitur diskutimet në grupin e tyre. Kjo realizohet edhe gjate prezantimit të detyrave të kursit duke krijuar një ambient bashkëpunues. Grupi i studenteve në takim vlerësonte maksimalisht formën e diskutimit me grupin e tyre gjate zhvillimit të mësimit. Numri i vogël i studenteve në kurs është edhe një faktor që ka nxitur këtë marrëdhënie interaktive mes pedagogut dhe studentit.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Plani mësimor i programit</i> <i>Takimi me stafin akademik dhe studentet e programit</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se ky i fundit ka të plote kuadrin rregullator ,mbikëqyrës dhe procedural të vlerësimit të dije të studenteve gjate procesit mësimor.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive të studentëve bazohet në praktikat tashme të njohura të përdorura në IAL në Shqipëri. GVJ, gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, evidentoi praktika të këtij programi, në disa nga lëndët për të cilat ishte përmbyllur vlerësimi. Njohuritë e marra gjatë procesit të zhvillimit të këtyre lëndëve vlerësohen me nga 10% deri në 40 % (angazhim në seminar, provimi i ndërmjetëm dhe detyra e kursit), një nivel ky relativisht i ulët për një vlerësim të vazhduar të studentit, ndërsa provimi përfundimtar zë deri 80% të vlerësimit, duke reflektuar kështu edhe përcaktimin e këtij vlerësimi sipas syllabusit për të cilët GVJ ka dhënë sugjerimet për përmirësim. Mendojmë se kjo metodë vlerësimi i jep mundësi studentit të angazhohet gjatë gjithë semestrit dhe siguron një vlerësim më objektiv të angazhimit të tij në auditor dhe jashtë tij.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Syllabuset e programit Bachelor në FK</i> <i>Rregullorja e programit Bachelor në FK</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentëve përcaktohen në rregulloret përkatëse në nivel institucioni, njësie kryesore dhe njësie bazë. Për të gjitha lëndët e programit realizohet testimi dhe vlerësimi me shkrim. GVJ evidentoi një praktikë të tillë ku u pa që ruhej sekreti dhe konfidencialiteti i testit si dhe bëhej sekretimi përkatës i tezës dhe zgjidhjes së studentit. Vitin e fundit USH është në hapat e para të vlerësimit elektronik “clean scoring” duke startuar këtë proces. Mendojmë që në kuadrin rregullator të institucionit dhe rregulloren e programit të evidentohet edhe ky lloj vlerësimi dijesh.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Syllabuset e programit Bachelor në FK</i> <i>Rregullorja e programit Bachelor në FK</i> <i>Projekti Clean Score</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e USH, e në rregulloren e këtij program dhe programet e lendeve, GVJ evidentoi praktike vlerësimi të studenteve ku konfirmohet se vlerësimi përfundimtar reflekton zbatimin e këtyre akteve rregullative. Vlerësimi përfundimtar i</p>

	<p>bazuar në pike reflektohet në notën përkatëse që është i detyrueshëm.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Syllabuset e programit Bachelor në FK</i> <i>Rregullorja e programit Bachelor në FK</i> <i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi nga 20% deri 40% të pikëve të dijeve gjatë vitit është një angazhim relativisht i mangët i studentëve. Rritja e këtij pragu e kombinuar me diskutime me intensive me pedagogun e lendes do të përmirësoje procesin e mësimnxënien se tyre sidomos kjo për detyrat e kursit të cilat në shumicën e lëndëve karakterizuese janë edhe aplikative. GVJ evidentoi formatin e disa testeve dhe konstatoi që format e pyetjeve dhe ushtrimeve praktike përmbajnë elementë standard të vlerësimit: pyetje me alternativa, pyetje me koment, ushtrime etj</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Syllabuset e programit Bachelor në FK</i> <i>Rregullorja e programit Bachelor në FK</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Bazuar në kuadrin rregullator në nivel institucional dhe të njësisë bazë, DFK në bashkëpunim me strukturat në nivel institucional (NJSBC) monitoron zhvillimin normal të testimit duke u përpjekur që ai të jetë realist dhe vlerësimi të jetë meritë e angazhimit të studentëve me njohuritë e kërkuara duke eliminuar sa më shumë format e kopjimit apo të abuzimit në këtë drejtim në rregulloren përkatëse evidentohen edhe mjaft detaje në funksion të realizimit të provimit sa me serioz. Problematikat rreth procesit mësimor evidentohen edhe në raportin e analizës mësimore të vete Departamentit të Finance Kontabilitetit i cili në të bën edhe analizën Swot.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Analiza e pyetesoreve të studenteve për programin Bachelor në FK</i> <i>Raport i analizës mësimore DFK për vitin 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Realizimi me korrektësi i testeve gjatë vitit akademik dhe në fund të tij është një garanci për vlerësimin e saktë të studentëve. Përgjigjet e testimit merren nga studentët brenda 5 ditëve nga zhvillimi i tij dhe ata kanë të drejtën e reklamimit të tij, siç edhe është parashikuar në rregulloren përkatëse.</p> <p><i>Rregullorja e studimeve në USH</i> <i>Rregullorja e programit Bahelor në FK</i></p>

<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Nga takimi me studentët, GVJ evidentoi faktin se përpara se pedagogu të dërgojë procesverbalin në sekretarinë mësimore lihet një ditë reklamimi për ta nëse ndonjë ka paqartësi apo pretendime mbi vlerësimin. Ky proces është i sanksionuar edhe në kuadrin rregullator të brendshëm të USH dhe rregulloren e vete programit.</p> <p>Praktikat e ankimimit të studentëve lidhur me vlerësimin kanë qenë të pakta në numër të evidentuara nga takimi me grupin e studenteve. Por, në rastet e evidentuara, Departamenti ngre komision vlerësimi të posaçëm dhe procesi dokumentohet deri në fund. GVJ evidentoi një rast ankimimi të studentit për regjistrimin e tij, ku problemi është sqaruar dhe i është dhënë shpjegimi studentit ankimues</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Rregullorja e programit Bahelor në FK</i></p> <p><i>Ankese student për regjistrim në program</i></p> <p><i>Rregullorja e programit Bahelor në FBSPP</i></p> <p><i>Takimi me studentet e programit</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se arrihet një vlerësim i drejtë i dijeve të studenteve duke respektuar konfidencialitetin, paanësinë dhe të drejtën e ankimimit nga studentet dhe zgjidhjes se saj.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.4</p> <p>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi arrin të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme kryesisht në fushën e financës dhe kontabilitetit, por edhe të menaxhimit. Programi synon që të rrisë edhe kompetencat profesionale të studentëve me fokus rritjen e aftësive praktike në këto drejtime. Mbështetur në 34 module që ofron programi, por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teorik dhe relativisht edhe atë profesional të studentëve. Në këtë kuadër</p>

	<p>praktika profesionale dhe përgatitja e diplomës që synohet të jetë aplikative, i shërbejnë këtij objektivi dhe rrisin më shumë përgatitjen profesionale të studentëve.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Rregullorja e programit Bahelor në FK</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Bazuar në programin mësimor, ky program studimi garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në finance kontabilitet nëpërmjet lendeve karakterizuese. Nga takimi me stafin dhe studentet rezultoi që aftësitë e veçanta në fushën e informacionit e teknologjisë arrihen kryesisht nëpërmjet trajtimin e rasteve studimore, apo detyrave të kursit si dhe tema të caktuara që zhvillohen në laborator. Megjithatë siç edhe kemi theksuar dhe propozuar edhe me lart përfshirja e lendeve të reja me fokus të drejtpërdrejtë fushën e teknologjisë dhe informacionit në lëndet si “, e-biznesi dhe e-banking” etj, do rriste me shume këto aftësi që tashme janë bere të domosdoshme. Gjate periudhës se pandemisë COVID-19 mësimi është realizuar përmes platformave të mirënjohura tashme si Google lassroom, sistemi Tims etj. Për mbarëvajtjen e procesit mësimor në kete periudhe institucioni hartoi dhe udhëzime dhe rregullore përkatëse. Kështu Senati i USH me vendimin nr.1143 date 3.04.2020 miratoi procesin dhe format e mësimimit online.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Rregullorja e programit Bahelor në FK</i> <i>Vendim miratimi procesi mësimi online.</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studentit, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmyllëse.</p>	<p>Nga takimi me stafin e programit dhe studentët, GVJ evidentoi që në orën e fundit të leksionit bashkëbisedohej mes pedagogut dhe studentit mbi realizimin e programit të lëndës bazuar në syllabusin e paraqitur që në fillim të semestrit) si dhe orientoheshin këta të fundit për provimin final.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>(Evidentim nga vizita në institucion dhe takimi me stafin akademik dhe studentet.)</i></p>

<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionit dhe takimin e zhvilluar me stafin e programit të studimit dhe studentet e këtij programi konstatohet që pedagogje të disa lendeve realizonin zhvillimin e programit në tema të caktuara nëpërmjet punëve laboratorike. Në disa raste përgatitja dhe mbrojtja e detyrës se kursit behet në laboratorin e informatikës. Një rol të rëndësishëm në formimin praktik të studenteve luan edhe realizimi i praktikës profesionale e cila është mundësuar në drejtimet kryesore që ofron ky program dhe që orientohet nga paketa e praktikës për programin Bahelor. Me vendim të Senatit të USH nr.2122 date 21.06.2019 është miratuar paketa e praktikës profesionale. Në këtë dokument jepen gjithë modalitetet e realizimit të këtij komponenti të rëndësishëm të programit , si dhe marrëveshja mes USH dhe institucionit/biznesit si dhe detyrimi i mbrojtjes se saj para komisionit me note.</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Paketa e praktikës profesionale</i></p> <p><i>Evidentim nga vizita në institucion dhe takimi me stafin akademik dhe studentet.</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni në mënyrë aktive realizon aktivitete në formën e takimeve, leksioneve të hapura me pjesëmarrjen e profesionisteve të fushave përkatëse. Në rang njësie baze, në evidentuam kalendarin e aktiviteteve të DFK ku pjesëtarë të stafit akademik parashikonin të realizonin takime trajnimi me studentet dhe profesioniste jashtë institucionit. Në dokumentacionin e aplikimin prezantohet edhe raporti i aktiviteteve dhe trajnimeve profesionale që janë organizuar në institucion. Bazuar në dokumentacionin e aplikimit pranë ASCAL-it evidentohen se gjate periudhës 2018-2022 janë realizuar një numër takime trajnimi dhe leksione të hapura me personalitete të njohura të fushës se ekonomisë dhe financës.</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Trajnim mbi metodat bashkëkohore të mësimdhënies (2018-2019)</i></p> <p><i>Raport i aktiviteteve të Departamentit FK</i></p> <p><i>Raportim mbi leksionet e hapura gjate periudhës 2017-2020</i></p>

Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit Bachelor në FK arrin të përmbushë objektivat e tij duke pajisur studentet me njohuri teorike praktike dhe me aftësi profesionale në fushën e financës, bankës, sigurimeve dhe pasurisë së paluajtshme. Përmbajtja e këtij program u jep mundësi të diplomuarve të kenë një spektër të gjer e punësimit në tregun e punës në të katër drejtime e programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Studentët e këtij programi, pas përmbjlljes së gjithë detyrimeve dhe mbrojtjes së praktikës, kanë të drejtën e mbrojtjes së diplomës përmes një punimi (ku kriter është nota mesatare mbi 8.5) ose nëpërmjet dhënies se provimit të formimit si provim i përgjithshëm. Procedura e mbrojtjes përfundimtare, diplomimit, është e përcaktuar në rregulloren e studimeve të USH, në rregulloren e këtij programi, si dhe në një dokument të posaçëm për këtë program studimi “Paketa e provës finale” ku jepen të gjitha modalitetet e këtij procesi. Ky proces zbatohet nga DFK. Këtu jepen detaje lidhur me grupin e lendeve të provimit të formimit. Gjithashtu në një dokument me vete (paketa e provës finale) jepen procesi i përgatitjes së punimit të diplomës, strukturën e punimit të diplomës, listën e pedagogëve udhëheqës, listën e sugjeruar të temave të mundshme orientuese etj. Dy nga studentet që në takuam gjatë vizitës në institucion ishin të kursit të III-te dhe do të përgatitjes përfundimtare të punimit apo përgatitjes për provimin përfundimtar.</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Paketa e provës finale</i></p> <p><i>Rregullore e studimeve në USH</i></p> <p><i>Rregullore e programit të studimit Bachelor në FK</i></p> <p><i>Evidentim nga vizita në institucion</i></p>

<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>DFK, si njësi bazë e programit, së bashku me strukturat ndihmëse, informojnë, ndjekin dhe monitorojnë procesin e mbrojtjes së diplomës me punimin e diplomës. Pas marrjes së informacionit studentët plotësojnë formularin e aplikimit ku përcaktojnë fushën e studimit, strukturën paraprake të tij dhe propozimin për udhëheqësin e punimit. Në DFK përcaktohen udhëheqësit për çdo student, të cilët kanë përgjegjësi për mbarëvajtjen e këtij procesi, cilësinë dhe përfundimin në afat. Ky proces u evidentua edhe gjatë vizitës në institucion.</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Paketa e provës finale</i></p> <p><i>Rregullore e studimeve në USH</i></p> <p><i>Rregullore e programit të studimit Bachelor në FK</i></p> <p><i>Evidentim nga vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Lidhur me diplomimin e studentëve, me vendim të përgjegjësit të DFK dhe miratim nga Dekani, ngrihet Komisioni i Provimit të Formimit i cili në vlerësimin e punimit të diplomës bazohet në katër kritere kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ecurinë dhe nivelin e vlerësimit të marrë në mësimet gjatë vitit akademik; • Vlerat teorike shkencore dhe profesionale të punimit; • Vlerësimin që jep pedagogu udhëheqës i punimit të studentit në formularin përkatës; • Nivelin e prezantimit të punimit nga studenti; <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Paketa e provës finale</i></p> <p><i>Rregullore e studimeve në USH</i></p> <p><i>Rregullore e programit të studimit Bachelor në FK</i></p> <p><i>Evidentim nga vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar.</p>	<p>Në funksion të fushës së punimit të propozuar nga studenti, DFK miraton listën e pedagogëve udhëheqës për temat e studentëve. Udhëheqësit e punimeve të diplomës gjatë periudhës së përgatitjes së tij nga studenti mbajnë komunikim të vazhdueshëm duke i orientuar përgjatë kësaj kohe. Roli udhëheqës i pedagogut është këshillues dhe orientues lidhur me përmbushjen e objektivave të qëllimit të punimit, shfrytëzimin e literaturës bashkëkohore nga studenti dhe përfshirja e analizës teorike praktike në punim.</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Format udhëzues për diplomimin</i></p>

<p>Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p><i>Paketa e provës finale</i> <i>Rregullore e studimeve në USH</i> <i>Rregullore e programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Evidentim nga vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Pedagoget përkatës që janë udhëheqës të punimeve të diplomimit mbështesin studentin për realizimin me sukses të punimit duke ofruar infrastrukturën teknike të institucionit kryesisht laboratorët si dhe të dhe data basë që kane në dispozicion.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Paketa e provës finale</i> <i>Rregullore e USH</i> <i>Rregullore e programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Evidentim nga vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Komisioni i Provimit të Formimit bazuar në katër kriteret e përmendura më lart, bën vlerësimin e punimit të diplomës me notë përfundimtare. në rregulloret përkatëse janë të përcaktuara edhe rastet e vlerësimit negativ të provimit përfundimtar si dhe kohe e lënë në dispozicion për studentin për tu rivlerësuar. në vitin akademik 2021-2022 nga ky program janë 88 studente.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Paketa e provës finale</i> <i>Rregullore e USH</i> <i>Rregullore e programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Evidentim nga vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve bazuar në rregulloret e përmendura më lart studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e saj të miratuar nga MASR. Diplomës i bashkëngjitet edhe lista e notave. Me vendim të Senatit të USH nr2121 date 26.12.2019 është miratuar formati i diplomës për programin Bachelor. Institucioni është në hapat e para të pajisjes se të diplomuarve me suplementin e diplomës pasi vendimit nr1679 date 18.11.2022 të Senatit Akademik të USH.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Rregullore e programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Suplementi i Diplomës, formati</i> <i>Miratimi i formatit të Diplomës</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me</p>	<p>Nga vizita në institucion rezultojnë se procesi i ruajtjes së gjithë dokumentacionit bazohet në kërkesat ligjore dhe aktet</p>

legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	nënligjore në fuqi. Gjithashtu të dhënat e tij ruhen edhe në sistemin informativ të institucionit. GVJ evidentoi dhe kontrollon me zgjedhje dy dosje të studenteve të këtij programi të cilat kishin dokumentacionin e nevojshëm që në vitin e regjistrimit të tyre. <i>Referenca:</i> <i>Evidentim nga vizita në institucion</i>			
Konkluzione	GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se procedura e përmbylljes së studimeve në të dyja format; me punim diplome apo provim formimi është e plotë dhe garanton një vlerësim të drejtë të diplomimit të studentit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të	Bazuar në dokumentacionin shoqëruar të paraqitur në RVB dhe nga vizita në institucion GVJ konstaton që personeli akademik dhe ndihmës akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit Bachelor në Financë - Kontabilitet ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit në përputhje me kërkesat bashkëkohore të sigurimit të cilësisë të moduleve mësimore. Nga dokumentacioni, numri dhe kualifikimi i stafit akademik të angazhuar në Departamentin e për periudhën 2020- 2023 është si më poshtë:

programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

1. Për vitin akademik 2020- 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 38 pedagogë nga të cilët 24 PAE dhe 14;
2. Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 39 pedagogë nga të cilët 23 PAE dhe 16 PAK;
3. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 38 pedagogë nga të cilët 24 PAE dhe 14 PAK;

Tituj/grada	2020 - 2021		2021 - 2022		2022 - 2023	
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:
Prof.Dr	2	-	2	-	2	-
Prof.As.Dr	5	-	5	-	4	-
Dr/PhD	14	1	14	1	14	1
Msc	3	13	2	15	4	13
Në total	24	14	23	16	24	14

Gjithashtu, GVJ konstaton se fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon këtë program studimi është në përputhje me natyrën e programit si edhe cilësitë specifike të moduleve të tij.

Referenca:

RVB Bachelor Finance - Kontabilitet 2020 -2023.docx

Tabelat permbledhese per anekset RVB 2020 -2023 (2)tabela 4.pdf

Rregullore, amendime dhe udhëzim për punësimet në USH (2).pdf

Cv stafi i brendshëm finance - kontabilitet (2).pdf

Vizita në Institucion

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

GVJ konstaton se angazhimi i personelit akademik pranë programit të studimit Bachelor në Financë- Kontabilitet është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, kërkuar gjatë vizitës në institucion mbulimi i ngarkesës mësimore për gjatë tre viteve akademike rezulton si më poshtë:

Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)
------	-------------	-----	-----	-------------

2020-2021	3335	2147	1188	64% / 36 %
2021-2022	3435	1962	1473	57% / 43%
2022-2023	2974	1996	978	67% / 33%

Nga tabela rezulton që për 3 vitet akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, nuk është përballuar me mbi 70% nga stafi akademik me kohë të plotë, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 ku citohet: “Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për cdo program studimi”, në përputhje me fushën e kualifikimit dhe fushën kërkimore të anëtarëve të stafit.

GVJ rekomandon që Institucioni të marrë masa për përballimin e ngarkesës mësimore të programit të studimit Bsc “Financë Kontabilitet” në masën 70% nga PAE, në plotësim të standardit të kërkuar.

GVJ konstaton një ngarkesë totale të personelit akademik mbi normën e parashikuar sipas nivelit të kualifikimit, por brenda parashikimeve të mbingarkesës së lejuar sipas kuadrit rregullator në fuqi që merr parasysh numrin maksimal të lëndëve që mund të mbulojë një pedagog dhe orë të suplementare.

Referenca:

RVB Bachelor Finance - Kontabilitet 2020 -2023.docx

Tabelat përmbledhëse për anekset RVB 2020 -2023 (2), tabelat 12.1-12.3.pdf

Ngarkesat pedagoge departamenti finance - kontabilitet 2020 -2023.pdf

Vizita në Institucion

Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime

Referuar DVV, RVB dhe gjithashtu vizitës në institucion GVJ konstatoi qëndrueshmëri të personelit akademik efektiv të angazhuar në programin Bachelor në Financë- Kontabilitet dhe Departamentin Financë- Kontabilitet. Punësimi i stafit është në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Ndryshimi i konstatuar në stafin akademik efektiv rezulton më pak se 5%.

Referenca:

Kontratat e punësimit dhe vërtetim sigurimet shoqërore dhe shëndetësore nga zyra e financës

shoqërore dhe shëndetësore.	<i>Vizita në Institucion</i>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>RVB dhe dokumentacioni i DVV paraqet qartë procedurën e rekrutimit të stafit me kohë të plotë. Njësia bazë bazohet në rregulloren për punësim të USH, e cila paraqet qartë kriteret. Rregullorja përcakton qartë procedurën që ndiqet në vlerësimin e kandidatëve në konkurrim, si dhe rregullat për përbërjen dhe përzgjedhjen e komisionit që drejton konkursin për vendin e lirë të punës.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Rregullore, amendime dhe udhëzim për punësimet në USH (2).pdf</i> <i>Kontratat e punësimit dhe vërtetim sigurimet shoqërore dhe shëndetësore nga zyra e financës</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi që Fakulteti Ekonomik ka staf ndihmës për departamentin duke përfshirë dhe asistenten e angazhuar në punët administrative. Gjithashtu pjesë e stafit ndihmës për realizimin e orëve laboratorike janë dhe 2 laborantë të cilët asistojnë në ambientet e laboratorëve, të cilët përdoren nga stafi akademik i Departamentit të Financë- Kontabilitetit gjithashtu.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Tabelat përmbledhëse për anekset RVB 2020 -2023 (2).pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për</p>	<p>GVJ konstatoi nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion që USH, me përgjegjës degën e Burimeve Njerëzore mbledh dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e stafit të angazhuar në programin Bachelor në Financë- Kontabilitet. Dy dosje rastësore të personelit u verifikuan dhe GVJ konstatoi plotësinë e tyre në përputhje me formatin e miratuar. Përgjegjësi i Departamentit, mbledh, përditëson dhe arkivon çdo vit CV-të e anëtarëve të personelit akademik dhe administrativ të përfshirë në programin e studimit.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Tabelat përmbledhëse për anekset RVB 2020 -2023 (2).pdf</i></p>

<p>organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p><i>Cv stafi i brendshëm financë – kontabilitet</i> POLITIKA E PRIVATËSISË <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi që USH në nivel institucioni por edhe Fakulteti Ekonomik dhe vetë Departamenti i Financë- Kontabilitetit kanë marrëveshje bashkëpunimi me IAL të tjera, institucione dhe organizata biznesi të cilat ndihmojnë dhe ofrojnë studentëve të programit Bachelor në Financë- Kontabilitet praktika profesionale. Praktika profesionale realizohet mbështetur në marrëveshjet e nënshkruara nga USH-ja me institucione dhe biznese të Shkodrës dhe rajonit. GVJ konfirmoi këtë proces dhe nga takimi me studentët e programit.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Marrëveshjet e bashkëpunimit të FE-së me institucionet dhe universitetet e tjera</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Bazuar RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se personeli akademik i departamentit angazhohet në ndjekjen e praktikave profesionale të studentëve të programit. Gjithashtu ato realizojnë vizita në ambientet e praktikave dhe takime me studentët për ti orientuar në hartimin e raportit përfundimtar të praktikës. Stafi supervisor i praktikave është gjithashtu pjesë në procesin e vlerësimit të tyre në fund.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Shembull praktike bachelor viti akademik 2021 -2022, Studente i diplomuar, K.Vjerdha</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ shprehet në përmbushje kryesisht të këtij standardi bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe në RVB. FE dhe Departamenti i Financë-Kontabilitetit ka të angazhuar personel akademik dhe ndihmës për realizimin e programit. GVJ rekomandon që Institucioni të marrë masa për përballimin e ngarkesës mësimore të programit të studimit Bsc "Financë</i></p>

	<i>Kontabilitet" në masën 70% nga PAE, në plotësim të standardit të kërkuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve										
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Departamenti i Financë- Kontabiliteti zhvillon procesin mësimorë në godinën e Fakultetit Ekonomik të USH. Bazuar në dokumentacionin e ofruar, RVB dhe nga vizita në institucion, GVJ konstatoi që mjediset në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimorë për programin Bachelor në Financë- Kontabilitet janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme. Përkatësisht, në dispozicion janë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Mjedisi - FB</th> <th>Nr. Sallash</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Salla leksioni + seminari</td> <td>17</td> </tr> <tr> <td>Salla & Laboratorë informatike, për aktivitete, etj</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Zyra për stafin</td> <td>28</td> </tr> <tr> <td>Bibliotekë</td> <td>1</td> </tr> </tbody> </table> <p>GVJ konstatoi se USH ka mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve mësimore, kërkimore dhe administrative, të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një realizim sa më profesional dhe eficient të detyrave nga personeli i angazhuar në këtë program studimi.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Tabelat Mjediset e FE -së</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>	Mjedisi - FB	Nr. Sallash	Salla leksioni + seminari	17	Salla & Laboratorë informatike, për aktivitete, etj	3	Zyra për stafin	28	Bibliotekë	1
Mjedisi - FB	Nr. Sallash										
Salla leksioni + seminari	17										
Salla & Laboratorë informatike, për aktivitete, etj	3										
Zyra për stafin	28										
Bibliotekë	1										
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e</p>	<p>GVJ konstatoi gjatë vizitës që sallat që përdorën gjatë procesit mësimorë janë të pajisura dhe të përshtatshme për përdorim të projektorëve të cilët janë të lëvizshëm dhe thjeshtë të</p>										

<p>mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>montueshëm nga stafi akademik. Sallat e leksionit dhe laboratorit janë të pajisura me video projektorë, tabela bashkëkohore, kompjuterë dhe vende pune me internet. Laboratorët në dispozicion të programit Bachelor në Financë-Kontabilitet ofrojnë rreth 80 vende për studentët dhe disa software në dispozicion të lëndëve të ndryshme. Në godinën e përdorur nga Fakulteti i Biznesit ofrohen dhe zyrat e stafit janë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme për procesin mësimorë.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Tabelat Mjediset e FE -së</i> <i>Marrëveshje bashkëpunimi me IMB</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Bazuar në DVV, RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi që Fakulteti Ekonomik, i cili ofron programin Bachelor në Financë- Kontabilitet ofron për studentët dy laboratorë dhe gjithashtu salla dhe mjediset e tjera të pajisura me mjete e dhe brënda standarteve për të përmbushur kërkesat e programit dhe për të arritur objektivat e tij.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Projektet e FE-së të fituara</i> <i>Pajisjet kompjuterike të fituara nga projektet deri në 2020</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Fakulteti Ekonomik, i cili ofron programin Bachelor në Financë- Kontabilitet ofron për studentët dy laboratorë. Laboratorët ofrojnë pajisjet e duhura teknologjike dhe programet standarde dhe specifike si SPSS, GRETL dhe ALFA të cilat janë në dispozicion të studentëve dhe të përshtatshme sipas natyrës dhe nevojave të programit të studimit.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Mjediset e FE -së</i> <i>Marrëveshje bashkëpunimi me IMB</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>

Konkluzione	<i>GVJ shprehet se ky standard është i përmbushur plotësisht pasi bazuar në DVV dhe në vizitën në institucion është konstatuar që USH ka në dispozicion të Fakultetit Ekonomik godinën e cila mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve mësimore, kërkimore dhe administrative, të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një realizim sa më profesional dhe eficient të procesit mësimorë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe në vizitën në institucion konstatoi që pedagogët e lëndëve paraqesin çdo fillim semestri të studentët literaturën bazë dhe ndihmëse që do nevojitet gjatë semestrit e cila mundësohet nga vetë ato dhe biblioteka. Tekstet bazë janë në gjuhën shqipe, të autorëve shqiptarë dhe përkthime të autorëve të huaj të cilat shpërmdahen si materiale shtesë me iniciativë të pedagogëve.</p> <p><i>GVJ rekomandon një përditësim më dinamik të literaturës pasi për shumë lëndë raportohet një literature e pa përditësuar.</i></p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i></p> <p><i>Syllabuset për vitet akademike 2020-2023</i></p> <p><i>Fondi i librave ekonomik në BUSH</i></p> <p><i>Librat ekonomik të dhuruar nga Sandhill Community College</i></p>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe në vizitën në institucion konstatoi çdo fillim semestri stafi akademik bën përditësimin e literaturës në përdorim të çdo lënde në mënyrë që të garantohet marrja e njohurive të nevojshme por dhe sa më bashkëkohore. Tekstet bazë janë në gjuhën shqipe, të autorëve shqiptarë dhe përkthime të autorëve të huaj të cilat shpërmdahen si materiale shtesë me iniciativë të pedagogëve.</p>

	<p>GVJ konfirmoi në takim me stafin procesin e përditësimit të literaturës e cila inicohet nga kërkesat e tyre në njësinë bazë, e cila ndjek procesin më pas.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Fondi i librave ekonomik në BUSH</i> <i>Librat ekonomik të dhuruar nga Sandhill Community College</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi që USH vë në dispozicion të studentëve dhe stafit të Fakultetit të Biznesit bibliotekën e cila mundëson tre salla leximi me 300 vende leximi në total, ambiente studimi dhe sociale të shfrytëzueshme për aktivitet kërkimorë dhe veprimtari promovuese. Studentët e USH kane akses dhe në Online Public Access Catalog, e cila lejon kërkimin në të gjithë fondin e BUSH. Biblioteka mund të shfrytëzohet njëlloj nga të gjithë studentët dhe personeli i universitetit.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Hapësira për student, fakultet dhe BUSH</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka disponon dhe një fond të mbyllur me literaturë të përditësuar si në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja, fondi fizik i saj është i përbërë nga 111 000 tituj libra akademike, dhe gjithashtu është e pajisur me revista, gazeta, fjalorë dhe enciklopedi, arshivë akademike fizike dhe digjitale, të gjitha në dispozicion për mbulimin e procesit mësimorë. Veçanti për Bibliotekën Universitare përbën biblioteka austriake e hapur në mjediset e saj që në vitin 2000. Sot kjo bibliotekë numëron rreth 14.000 libra, periodikë dhe cd/dvd. GVJ gjatë vizitës në bibliotekë konfirmoi informacionin sa më sipër.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Fondi i librave ekonomik në BUSH</i> <i>Librat ekonomik të dhuruar nga Sandhill Community College</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e</p>	<p>GVJ konstatoi nga takimi me stafin dhe studentët e programit Bachelor në Financë- Kontabilitet, që USH ofron për të gjithë dhe pa pagesë përmes sportelit të huazimit, sportelit të</p>

<p>pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>informacionit, mediatekës, e cila është e pajisur me 30 vende multimedia si dhe tri sallave të leximit afërsisht me 300 vende leximi. Biblioteka Universitare Shkencore siguron akses pa pagesë në burimet ndërkombëtare elektronike me tekst të plotë nga: BioOne, Cambridge Journals Online, EBSCO Academic Search Complete, Emerald Engineering ejournal collection, OECD library etj.</p> <p><u>Referenca:</u> http://bush.unishk.edu.al/sherbimet/ http://bush.unishk.edu.al/instrumente/kataloge-online/ Vizita në Institucion</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>GVJ konstatoi nga takimi me stafin dhe studentët e programit Bachelor në Financë- Kontabilitet, që Biblioteka ofron informacione online nga burime ndërkombëtare elektronike me tekst të plotë për stafin e pedagogëve, studentëve dhe përdoruesve të tjerë të BUSH. Biblioteka Universitare Shkencore siguron akses pa pagesë në burimet ndërkombëtare elektronike me tekst të plotë nga: BioOne, Cambridge Journals Online, EBSCO Academic Search Complete, Emerald Engineering ejournal collection, OECD library etj. Biblioteka e USh-së ka në shfrytëzim platformën ULibrary që mundëson rritjen e interaktivitetit të shërbimeve të bibliotekës me studentët. Biblioteka është e pajisur me teknologjinë e nevojshme për të lehtësuar veprimtaritë kërkuese dhe studimore.</p> <p><u>Referenca:</u> https://ulibrary.rash.al/ http://bush.unishk.edu.al/instrumente/kataloge-online/ Hapësira për student, fakultet dhe BUSH Vizita në Institucion</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të</p>	<p>GVJ konstatoi që Biblioteka e USh operon sipas një rregulloreje dhe ofron shërbim studentëve çdo ditë të javës, duke përfshirë dhe ditën e Shtune, në mënyrë që shërbimi për studentët të jete jo vetëm në oraret e tyre sipas programeve të studimeve por edhe e pandërprerë.</p> <p><u>Referenca:</u> Vizita në Institucion</p>

studentëve dhe kapacitetit të saj.				
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin e fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	<p>Bazuar në RVB, dokumentacionin e ofruar, dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi që Departamenti i Financë-Kontabilitetit, përgjegjëse për programin e Bachelor në Financë- Kontabilitet, në periudhë të vazhdueshme evidenton nevojat e fondit fizik të bibliotekës dhe ndjek procesin e përditësimit të këtij fondi.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Fondi i librave ekonomik në BUSH</i> <i>Librat ekonomik të dhuruar nga Sandhill Community College</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ shprehet se ky standard është i përmbushur kryesisht, kjo e konstatuar nga GVV dhe vizita me stafin dhe studentët e programit Bachelor në Financë- Kontabilitet. Literatura bazë dhe ndihmëse e programit u mundësojnë studentëve të marrin njohuritë e nevojshme të parashikuara në program. Por GVJ rekomandon në një përditësim të literaturës më dinamike pasi për shumë lëndë raportohet një literature e pa përditësuar.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi nga DVV dhe vizita në institucion që Sekretaria e Fakultetit Ekonomik realizon sistemin e menaxhimit të informacionit që lidhet me studentët. Gjatë takimit në sekretarinë e programit u bë e mundur shqyrtimi i regjistrave të studentëve dhe dy dosje të zgjedhura të studentëve në programin Bachelor në Financë- Kontabilitet, të cilat rezultuan me informacion të plotë të nevojshëm sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi. Sistemi tjetër i menaxhimit të informacionit në përdorim është platforma PITAGORA si një sistem i informatizuar për të administruar të dhënat për të gjithë studentët që nga hyrja në universitet e deri në diplomimin e tyre.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Miratim + rregullore bachelor finance - kontabilitet (2).pdf</i> <i>Platforma Pitagora</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>GVJ konstatoi se informacioni mbi stafin akademik dhe ndihmës akademik dhe partnerët e angazhuar në programin Bachelor në Financë- Kontabilitet menaxhohet dhe arkivohet nga struktura e Burimeve Njerëzore. Departamenti i Financë- Kontabilitetit mbledh dhe përditëson informacionin akademik dhe shkencorë të stafit dhe e arkivon. Gjatë vizitës u shqyrtuan dy dosje fizike të stafit, të cilat rezultuan me informacion të përditësuar.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Platforma SMACK</i> <i>Cv stafi i brendshëm finance – kontabilitet</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se platforma PITAGORA, garanton akses të dedikuar për të gjithë përdoruesit dhe me funksionalitetet e nevojshme të komunikimit për aspektet mësimore të ciklit akademik të studimeve pranë USH: si programet mësimore sipas cikleve të studimit, grafiku i provimeve, rezultatet deri në diplomim etj.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Platforma Pitagora</i> <i>Platforma Smack</i> <i>Politika E Privatësisë</i></p>

<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Platforma PITAGORA është sistemi që mbledh, ruan dhe përpunon të dhëna për stafin dhe studentët e USH, por GVJ konstatori si nga RVB dhe nga vizita në institucion që stafi përdor dhe platformat Google Classroom dhe dropbox si metoda interaktive për komunikim të vazhdueshëm me studentët dhe shpërndarjen e materialeve ndihmese dhe programit të lëndës.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Platforma Pitagora</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>GVJ gjykon se në tërësi sistemi i menaxhimit të USH garanton monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit si dhe mundëson evidentimin në kohë të problematikave dhe marrjen e masave për përmirësim nga strukturat përkatëse.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Platforma Pitagora</i> <i>Politika E Privatësisë</i> <i>Marrëveshja 1536 Orëshe</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ konstatoi se në faqen zyrtare web të USH publikohet në gjuhën shqipe i gjithë informacioni i nevojshëm mbi programet e studimit të ofruara, personelin akademik, aktivitetet e realizuara, si dhe shërbimet e njoftime të tjera për të gjithë të interesuarit. Gjithashtu rrjetet sociale të Departamentit paraqesin informacion të vazhdueshëm për të interesuarit.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i> https://unishk.edu.al/</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht, USH përdor disa platforma për administrimin e informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre pranë universitetit. Sistemi aktual i menaxhimit garanton monitorimin në kohë të aktivitetit akademik dhe administrativ të USH. Informacioni që lidhet me të gjitha programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet & projektet etj të USH publikohet në faqen zyrtare</i></p>

	të institucionit në internet në gjuhën shqipe dhe në rrjetet sociale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dhënë në DVV dhe RVB, gjithashtu në vizitën pranë institucionit GVJ konstaton Departamenti i Financë- Kontabilitetit ka një pjesë të veçantë në strukturën e buxhetit për USH, e cila përfshin zërat e kostove financiare dhe është në përputhje me strukturën buxhetore të Buxhetit të Shtetit të përcaktuar me udhëzim të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Planifikimi financiar dhe realizimi është i centralizuar, meqenëse fakultetet nuk kanë një administrator të vetin dhe për më tepër pavarësi në administrimin e tyre financiar. Ky plan financiar i cili përlllogarit kostot e mbulimit të ciklit të plotë të studimit por edhe tarifën dhe pagesat studentore, hartohet nga USH.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Rregullore Ekonomiko – Financiare</i> <i>Miratimi I Projekt – Buxhetit 2023</i> <i>Raportimi Financiar I Programeve Të Fe-Së</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor,</p>	<p>GVJ konstatoi nga shqyrtimi i DVV se institucioni harton raportin e analizës financiare për tre vitet e kaluara për të evidentuar masën e realizimit të të ardhurave si edhe nivelin e realizimit të shpenzimeve. Relacioni mbi projekt buxhetin afatmesëm dhe afatgjatë hartohet në mënyrë periodike nga njësitë përgjegjëse të USH-së. Pasqyra financiare e të ardhurave nga tarifën e studentëve dhe nga burimet e tjera të financimit bëhet publike në faqen eeb të USH-së.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Programi I Transparencës</i></p>

<p>shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2022-2023/Buxheti/RAPORTI_FINANCIARSHKURT2023__1_.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>USH auditohet çdo vit nga audimi i brendshëm. Burimet e financimit janë nga buxheti i shtetit, tarifa studentësh etj. Universiteti bën të njohur pasqyrën e të ardhurave nga tarifat e studentëve dhe burime të tjera për të pasur transparencë ndaj publikut.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Raport auditimi – model sekretaria mësimore</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Bazuar në informacionin e DVV, USH paraqet çdo vit akademik analizën vjetore për të gjithë veprimtaritë e kryera, pasqyrën financiare të lidhur me gjendjen, angazhimin e personelit, tarifat etj.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Programi I Transparencës</i> https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2022-2023/Buxheti/RAPORTI_FINANCIARSHKURT2023__1_.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të</p>	<p>USH është institucion buxhetor dhe funksionon sipas parimit të autonomisë financiare, në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Sipas kuarit rregullator në fuqi, burimet e financimit të USH janë: buxheti i shtetit; pagesat e studentëve për arsimim; të ardhurat për shërbimet e kryera; të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta; donacione dhe burime të tjera ligjore financimi; si dhe të ardhurat nga veprimtari kërkimore shkencore. Fondet e buxhetit të shtetit në përputhje me udhëzimet e MFE shpërndahen në formë granti për politikat e zhvillimit të USH, për mësimdhënien dhe për punën kërkimore-shkencore e veprimtaritë krijuese. Përdorimi i fondeve publike nga USH bëhet në përputhje me kushtet dhe qëllimet e grantit të akorduar. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, GVJ</p>

financimit të programeve të studimeve.	<p>konstatoi se për periudhën 2021-2023 ecuria e të ardhurave të realizuara paraqitet si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Viti 2021 rreth 59% fonde të grantit qendror dhe 41% fonde nga tarifat për dhe gjatë shkollimit; ▪ Viti 2022 rreth 58% fonde të grantit qendror dhe 42% fonde nga tarifat për dhe gjatë shkollimit; ▪ Viti 2023 (Janar- Qeshor) – rreth 29% fonde të grantit qendror dhe 71% fonde nga tarifat për dhe gjatë shkollimit; <p><u>Referenca:</u> Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Kërkesat buxhetore departamenti Financë – Kontabilitet 2022, 2023 Shtesa për financën.pdf</p>			
Konkluzione	<p>GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht, pasi u konstatua se USH harton raporte financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në nivel universiteti dhe njësie bazë dhe bën analiza financiare në nivel njësie bazë. Institucioni i nënshtrohet kontrollit dhe auditimit të brendshëm dhe raportet përcillen deri në njësinë bazë. USH si institucion buxhetor, garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në Statutin dhe Rregulloret e USH, si dhe informacionin e faqes web zyrtare të institucionit, GVJ konkludon se politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera rregullatore. Rregulloret e USH dhe FE specifikojnë hapat që ndiqen për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit. GVJ konstaton që këto akte janë në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p><i>Referenca:</i> Statuti Ush-Së Rregullore E Studimit Në USh Strategjia E Mësimdhënies Vizita në Institucion</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në Statutin dhe Rregulloret e USH, GVJ konkludon barazia dhe të drejtat e kandidatëve dhe studentëve të programit të studimit garantohej edhe nga kërkesat (nenet) specifike të statutit (nenet 78, 80 & 81) dhe rregullores së USH (neni 40), dhe të rregullores së FE (neni 48).</p> <p><i>Referenca:</i> Statuti USh-Së Rregullore E Studimit Në USh Strategjia E Mësimdhënies Rregullore e FE-së Rregullore e njësisë bazë Financë – Kontabilitet Vizita në Institucion</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të</p>	<p>GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit të DVV dhe RVB, dhe pas vizitës në institucion, konstatoi që USH harton dhe bën publike kriteret dhe kuotat e pranimi për çdo cikël studimesh, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Në USH, Departamentet propozojnë kriteret e pranimi për çdo program studimi që mbulojnë si dhe kriteret që do përdoren për përzgjedhjen e kandidatëve fitues. Drejtuesi i njësisë bazë dorëzon vendimin e departamentin për kriteret e propozuara tek njësia kryesore e cila ia përcjell drejtuesve të IAL-së së institucionit. Kriteret e propozuara u vihen në dispozicion të</p>

<p>maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin para fillimit të aplikimeve për pranime. Këto kritere parashikojnë dhe përfshijnë edhe kandidatë që kanë një diplomë të shkollës së mesme ekuivalente të një vendi të huaj. Pranimet e studentëve në të gjitha programet e studimit bëhen me vendim të veçantë, në përputhje me standardet shtetërore, kapacitetet akademike dhe infrastrukturore, të cilat verifikohen dhe certifikohen nga ministria përgjegjëse për arsimin, të ngritura nga njësi kryesore.</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Rregullore e Studimit Në Ush (Kreu II, Neni 1,2,3,4,5,6)Nr. 10, datë 15.5.2019 për Procedurat e Aplikimit dhe të Regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë</i></p> <p><i>Rregullore e FE-së</i></p> <p><i>Kriteret e pranimet 2022 -2023 departamenti financë – kontabilitet</i></p> <p><i>Shembull aplikimi per transferim studimesh</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimet dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e DVV dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se USH se procedurat dhe kriteret e përdorura në përzgjedhjen e studentëve, në vlerësimin përgjatë ciklit të studimeve e më pas, deri në diplomim, janë lehtësisht të kuptueshme dhe të disponueshme për të gjithë të interesuarit. Këto kritere dhe procedura janë të aksesueshme dhe në faqen zyrtare të universitetit.</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Rregullore e FE-së</i></p> <p><i>Rregullore e njësisë bazë Financë – Kontabilitet</i></p> <p><i>Miratim + rregullore bachelor financë – kontabilitet</i></p> <p><i>Guida Për Studentët</i></p> <p><i>https://unishk.edu.al/pranimet-e-studenteve-te-rinj-2022-2023</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e DVV dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se USH përveç komunikimit elektronik, për informimin e publikut shërbejnë dhe takimet me maturanët në ditët e informimit të maturanëve dhe aktiviteti që organizohet nga FE si përmbyllës i procesit të informimit të tyre, “Mirësevjen maturan”.</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Programi I Transparencës, Ush</i></p>

	<p><i>Kriteret e pranimit 2022 -2023 departamenti financë – kontabilitet</i></p> <p><i>Nr. 10, datë 15.5.2019 për Procedurat e Aplikimit dhe të Regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>GVJ konstatoi se USH ka hartuar kuotat e pranimit për kategori të veçanta si për kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare etj. Programi Bachelor Financë-Kontabilitet nuk përjashton mundësinë e integritit të shtresave më vulnerabël të shoqërisë. Kriteret pasi miratohen në Senat, dërgohen për miratim të Bordi i Administrimit të USH-së.</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Vendimi kuotat 2022 -2023 departament + vendim senat</i></p> <p>https://unishk.edu.al/universiteti/bursa</p> <p>https://unishk.edu.al/pranimet-e-studenteve-te-rinj-2022-2023</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Në kuadrin rregullator të USH parashikohet mundësia e regjistrimit pranë programeve të studimit edhe të studentëve të huaj, por që plotësojnë kriteret e parashikuara të pranimit në programin e studimit dhe në respektim të Udhëzimeve të MAS.</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Vendimi kuotat 2022 -2023 departament + vendim senat</i></p> <p>https://unishk.edu.al/pranimet-e-studenteve-te-rinj-2022-2023</p> <p><i>Kriteret e pranimit 2022 -2023 departamenti financë – kontabilitet</i></p> <p><i>Kriteret e pranimit 2023 -2024, departamenti financë – kontabilitet</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>USH duke ndjekur dhe kuadrin rregullator në fuqi, njofton dhe ofron bursa apo përfitim financiar për studentët e shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar.</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Programi I Transparencës, Ush</i></p> <p><i>Statuti I Ush-Së</i></p> <p>https://unishk.edu.al/universiteti/bursa</p> <p><i>Bursat vendim qeverie për programet proritare</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>

Konkluzione	<i>GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht, duke konstatuar se në kuadrin rregullator të USH parashikohen kriteret dhe procedurat e përgjithshme të pranimit të studentëve në programet bachelor, si dhe procedurat lidhur me ecurinë deri në diplomim, përfshirë vlerësimin e dijeve dhe mundësinë e transferimit në/nga programe të tjera. USH ka hartuar kuotat e pranimit për kategori të veçanta si për kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare etj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqëruar, informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare web të USH, GVJ vlerëson se në dispozicion të studentëve vihet informacion i plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre si dhe lidhur me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh. Rregulloret e Fakultetit dhe programit ofrojnë informacion mbi të gjithë procesin por USH aplikon gjithashtu dhe sistemin e automatizuar të Pitagorës, i cili jep akses studentëve të informohen në kohë reale për vlerësimet e tyre, programet e lëndëve dhe gjithë ciklit të studimeve.</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Rregullore e FE-së</i> <i>Rregullore e Programit Bachelor Financë-Kontabilitet</i> <i>Platforma Pitagora</i> <i>Platforma Esse 3</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të	Bazuar në dokumentacionin e DVV dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se USH përmes sekretarive të programeve të ciklit të parë dhe bazuar në rregullore të FE informon dhe orienton studentët në lidhje mundësinë për njohjen e krediteve dhe kualifikimeve të mëparshme. Kriteret e procedurat e

<p>mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në rregulloren e njësisë bazë për transferimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Informimi për njohjen e kualifikimeve të mëparshme dhe studimeve të pjesshme në Programin Bachelor “Financë-Kontabilitet” mund të sigurohet drejtpërdrejtë ose me kërkesë të të interesuarit tek njësia përgjegjëse për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e programit.</p> <p><u>Referenca:</u> Rregullore E Ush-Së (Kreu Iii, Neni 21) Rregullore e FE-së Rregullore e Programit Bachelor Financë-Kontabilitet Programi I Transparencës, Ush Vizita në Institucion</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi nga DVV dhe vizita me studentet se studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit nëpërmjet rregulloreve së fakultetit, departamentit dhe programit të studimit, syllabuseve të lëndëve të publikuara në platformen Pitagora dhe prezantimit të pedagogut përkatës në javën e parë të mësimin, si dhe nga sekretaria mësimore e departamentit.</p> <p>Studentët informuan GVJ se në cdo javë të parë të semestrit informohen dhe diskutojnë me pedagogët e lëndëve mbi procedurën e vlerësimit të tyre për çdo lëndë duke u njohur me syllabusin e lëndës, <u>por GVJ rekomandon rishikimin e shpërndarjes së vlerësimit të studentëve pasi është një përqindje e lartë e përcaktuar tek provimi përfundimtarë.</u></p> <p><u>Referenca:</u> Rregullore E Ush-Së (Kreu I, Neni 1,2,3,4 Dhe Neni 29) Rregullore e FE-së Rregullore e njësisë bazë Financë – Kontabilitet Rregullore e Programit Bachelor Financë-Kontabilitet Syllabuset 2020- 2023 Vizita në Institucion</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në takimin me studentët e programit të studimit Bachelor në Financë- Kontabilitet, GVJ konstatoi se studentët ishin të informuar lidhur me kriteret dhe procedurat e diplomimit të këtij programi studimi. Të drejtën për të punuar diploma në programin e studimit financë-kontabilitet e kanë studentët me mesatare mbi 8, duke iu referuar rregulloreve së studimeve në USH. Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin përfundimtar dhe pesha që zë</p>

	<p>secila kategori e veprimtarive formuese brenda programit të studimit, sipas llojit të programit, përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Rregullore E Ush-Së (Kreu V, Neni 37</i> <i>Format udhëzuesi teme diplome bachelor</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare të USH, GVJ konstatoi se çdo fillim viti akademik, Departament i Financë-Kontabilitetit në bashkëpunim me strukturat e tjera brenda institucionit zhvillon aktivitete informuese mbi programet e studimit. Gjithashtu, USH përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike publikon udhëzues të posaçëm.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Relacion mbi aktivitetin Miresevjen maturant '23+Relacion ditët e hapura nder vite</i> <i>Guida Për Studentët</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se USH vë në dispozicion të studentëve informacionin e plotë mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre përmes platformës së Pitagorës, si dhe mbi procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh. Gjithashtu studentët kanë informacion të plote mbi kriteret e vlerësimit të dijeve në këtë program studimi dhe procesin e diplomimit. <u>GVJ rekomandon rishikimin e shpërndarjes së vlerësimit të studentëve pasi është një përqindje e lartë e përcaktuar tek provimi përfundimtarë. USH, duke angazhuar staf të departamentit, organizon aktivitete informuese për studentët e interesuar.</u></i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konkludon se studentët e programit të studimit Bachelor në Financë-Kontabilitet informohen nga pedagogët përkatës, sekretaritet dhe faqja zyrtare web e USH për të gjitha detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe elementët ndihmës në funksion të këtij procesi. GVJ konstatoi se përveç rregulloreve përkatëse, në dispozicion të studentëve janë edhe udhëzues e materiale informuese të përgatitura mbi organizimin dhe strukturën e programit të studimit të cilat u jepen studentëve në ditët e para në auditor dhe në faqen zyrtare apo rrjetet sociale të institucionit. Përmes platformës në përdorim dhe takimeve të organizuara studentët mund të konsultojnë syllabuset dhe informacione të përditësuara mbi veprimtaritë mësimore.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Strategjia E Komunikimit Dhe Informimit Publik.</i> <i>Programi I Transparencës</i> <i>Rregullore E Ush-Së</i> <i>Rregullore E Programit Bachelor Financë-Kontabilitet</i> <i>Guida Për Studentët</i> www.unishk.edu.al <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ konstatoi se përveç rregulloreve përkatëse, në dispozicion të studentëve janë edhe udhëzues e materiale informuese të përgatitura mbi organizimin dhe strukturën e programit të studimit të cilat u jepen studentëve në ditët e para në auditor dhe në faqen zyrtare apo rrjetet sociale të institucionit. Përmes platformës në përdorim dhe takimeve të organizuara studentët mund të konsultojnë syllabuset dhe informacione të përditësuara mbi veprimtaritë mësimore.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Strategjia E Komunikimit Dhe Informimit Publik.</i> <i>Guida Për Studentët</i> www.unishk.edu.al <i>Vizita në Institucion</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se Fakulteti i Ekonomisë ka dhe lidh marrëveshje në vazhdimësi me institucione dhe biznese për të mbështetur studentet e tyre gjatë praktikave dhe mbi të gjitha për tju ofruar mundësi punësimi. Gjatë takimit me përfaqësues së zyrës së Alumnit dhe Karrierës dhe Fakultetit, GVJ u njoh me disa aktivitete që organizohen në kuadër të orientimit të studentëve drejt dhe në tregun e punës, ku më i rëndësishmi është Panairi i Punës, i cili tashmë është një traditë për USH.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Strategjia E Tregut Të Punës</i> <i>Rregullore E Zyrës Së Karrierës Dhe Alumnit</i> <i>Panairi i Punës</i> <i>Praktikë prezantimi për internship Raiffeisen Bank</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ konstatoi se Sekretaritet Mësimorë si dhe pedagogët e Departamentit të Financë- Kontabilitetit luajnë një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi, që në fazën e regjistrimit të studentëve e më pas me fillimin e vitit akademik.</p> <p>www.unishk.edu.al <i>Guida Për Studentët</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>GVJ konstatoi se nëpërmjet faqes web zyrtare të USH dhe hapësirës së dedikuar në platformën PITAGORA, studentët e këtij programi studimi mund të informohen edhe në distancë lidhur me strukturën e vitit akademik, organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën, shërbimet dhe aktivitete të tjera të USH. Gjithashtu studentët, sipas programit të studimit, mund të konsultojnë orarin mësimor, grafikun dhe rezultatet e provimeve si edhe materialet e postuara nga pedagogët në faqet tyre individuale të integruara në faqen zyrtare të USH.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Platforma ESSE 3</i> <i>Platforma PITAGORA</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>

Konkluzione	GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht pasi konstatoi se në USH studentët e programit të studimit Bachelor në Financë- Kontabilitet informohen nga pedagogët përkatës, sekretaritet dhe faqja zyrtare web e USH për të gjitha detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe elementët ndihmës në funksion të këtij procesi. FE ka dhe rrit numrin e marrëveshjeve, duke ua vënë në dispozicion studentëve me qëllim orientimin e tyre drejt tregut të punës, gjithashtu kujdeset për informimin dhe këshillimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit që ofron ky program studimi. Informimi në distancë realizohet edhe përmes faqes ëeb zyrtare të USH dhe hapësirës së dedikuar në platformën PITAGORA.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Bazuar në informacionin në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se USH mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar sipas programeve dhe cikleve të studimit. Konkretisht, Sekretaria Mësimore është struktura që në bashkëpunim edhe me Departamentet përgjegjëse, administron të gjithë informacionin lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim për çdo program studimi. <i>Referenca:</i> <i>Rregullore E FE-Së</i> <i>Të Dhëna Për Studentët Për Akreditimin</i> <i>Rregullore E Programit Bachelor Financë-Kontabilitet</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e	Gjatë vizitës në USH, GVJ konstatoi se regjistrat e sekretarisë mësimore (themeltar, i arritjeve akademike dhe ai i dhënies së diplomave) janë të formatuar dhe të përditësuar sipas standardeve ligjore në fuqi. Pranë sekretarisë depozitohen edhe

studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

dokumentacioni i përgatitur nga personeli akademik lidhur me frekuentimin e studentëve dhe procesverbalet e vlerësimeve sipas lëndëve. Të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi për 3 vitet e fundit akademike paraqiten si vijon:

Viti akademik	Të regjistruar	Të cregjistruarve	Të diplomuarve	Nr aktual
2020-2021	99	4	55	95
2021-2022	94	1	88	93
2022-2023	85	0	proces	85
Totali	273			

Të gjithë studentët e regjistruar në këtë program studimi janë të regjistruar me numër matrikullimi. Gjithashtu gjatë vizitës, GVJ verifikoi me zgjedhje dosjet personale dhe të ecurisë akademike të dy studentëve të programit të studimit Bachelor në Financë- Kontabilitet dhe konstatoi plotësinë e tyre.

Referenca:

Rregullore E Zyrës Së Karrierës Dhe Alumni

Raport Nga Zyra E Karrierës Dhe Alumnit

Vizita në Institucion

Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

Bazuar në informacionin e RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se ruajtja dhe menaxhimi i të dhënave statistikore të studentëve realizohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kërkesat e statutit dhe rregulloreve të USH dhe Fakultetit. Zyra e Sekretarisë Mësimore kujdeset drejtpërdrejt për ruajtjen e informacionit në formatin letër (regjistrat e sekretarisë mësimore, procesverbalet e provimeve & dosjet personale të studentëve) dhe në versionin elektronik (në sistemin e brendshëm informatik PITAGORA). Të dyja mënyrat e ruajtjes lehtësojnë kontrollin dhe përdorimin e të dhënave nga personat e autorizuar, si edhe japin siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Referenca:

	<p><i>Rvb Bachelor Finance - Kontabilitet 2020 -2023.Docx</i></p> <p><i>Politika E Privatësisë</i></p> <p><i>Rregullore E Studimit Në USh</i></p> <p><i>Platforma Pitagora</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se USh kontrollon në mënyre periodike në nivel fakulteti dhe universiteti të gjitha njësitë përgjegjëse për menaxhimin e informacionit lidhur me studentët dhe veprimtaritë e tyre përkatëse. Drejtoria e Auditit të Brendshëm kryen këtë kontroll.</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Statuti i USh-Së</i></p> <p><i>Rregullore e Studimit Në USh</i></p> <p><i>Raport Auditimi Model Sekretaria Mësimore</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre reguesve.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB Sekretaritë mësimore hartojnë raporte analitike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve. Zyra e këshillimit të karrierës disponon raportet në lidhje me punësimin e studentëve. Njësia bazë mbështetet në këtë informacion për të realizuar analizat periodike.</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Rregullore E Programit Bachelor Financë-Kontabilitet Tabelat Permbledhese Per Anekset Rvb 2020 -2023</i></p> <p><i>Raporti I Analizës Mësimore Departamenti Financë – Kontabilitet 2021 -2022</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se USh mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar, të diplomuar, si dhe të transferimeve në apo nga ky program studimi. Sistemi i brendshëm i informacionit i USh mundëson kontrollin e të dhënave nga personat e autorizuar dhe ruajtja jep siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Departamenti i Financë- Kontabilitetit në bashkëpunim me Zyra e Karrierës dhe Alumni analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje</i></p>

	të studentëve. Gjithashtu, Drejtoria e Auditit të Brendshëm kryen kontrolle periodike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se USH në përputhje me legjislacionin në fuqi, statutin dhe rregulloren e institucionit ka mundur ngritjen e Këshillave Studentore në nivel Fakulteti si dhe angazhimin e përfaqësuesve të studentëve në Senatin Akademik të USH, dhe në Bordin e Administrimit.</p> <p><u>Referenca:</u> Rregullore E Këshillave Studentorë Vendim Për Anëtarësimin Në Bord Të Përfaqësuesit Të Studentëve</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>GVJ konstatoi se në statutin e USH (neni 78) dhe rregulloret përkatëse parashikohet qartë garantimi i përfshirjes së studentëve në procesin e vendimmarrjes me përfaqësuesit e tyre të zgjedhur në një proces transparent.</p> <p><u>Referenca:</u> Vendim Për Anëtarësimin Në Bord Të Përfaqësuesit Të Studentëve Shkresa Këshilli Studentor Fakulteti - Organet Këshilluese Takimi Me Studentët</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe</p>	<p>GVJ konstatoi se aktualisht USH përdor në fund të çdo semestri pyetësorët për studentët për të vlerësuar procesin mësimor dhe stafin akademik. Në pyetësor studentët mund të komentojnë dhe japin sugjerime mbi lëndët dhe programet e studimit që ata ndjekin.</p>

<p>përmirësimin të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p><i>GVJ konstatoi se procedura e shpërndarjes së pyetësorëve të studentëve dhe mbledhja e informacionit nuk është e strukturuar mirë dhe nuk siguron pjesëmarrje të lartë duke lënë dhe paqartësi në sigurimin e anonimitit në këtë proces.</i></p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Formati i pyetësorit + shembull një raporti për Pedagogët FE</i></p> <p><i>Analizë e pyetësorëve program studimi bachelor financë – kontabilitet</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe në takimin me stafin dhe studentët e USH, GVJ konstatoi se në cdo fund semestri studentët kanë mundësi të reflektojnë dhe paraqesin vlerësimet e tyre mbi procesin mësimorë dhe procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve me anë të pyetësorëve të cilët mund ti plotësojnë për çdo lëndë dhe pedagog. <i>Proces ky që nuk është shumë i qartë dhe fiks për të gjitha lëndët, pasi nga takimi me stafin akademik, GVJ konstatoi dhe iniciativa personale të personelit për lëndët e tyre pasi informacioni i mbledhur nga pyetësorët nuk ka pjesëmarrje të lartë apo komente konkrete. Ndërkohë në periudhën e caktuar të sezonit të provimeve, studentët njoftohen nga pedagogët për rezultat e tyre në platformën në përdorim Pitagora, duke u dhënë dhe informacion mbi kohën në dispozicion për ballafaqimin me pedagogun e lëndës, ku studentët mund të diskutojnë mbi rezultatin e tyre dhe të reflektojnë gabimet e tyre.</i></p> <p><i>Gjithashtu, në këtë aspekt, gjatë takimit me studentët, GVJ konstatoi se studentët paraqesin nevojë për më shumë komunikim me personelin akademik.</i></p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Statuti I Ush-Së Rregullore E Ush-SË Rregullore e FE-së Rregullore e Programit Bachelor Financë-Kontabilitet</i></p> <p><i>Ankesë studenti për pranim në programin bachelor</i></p> <p><i>Shembull korrigjim note provimi</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se USH ka mundësuar angazhimin e përfaqësuesve të studentëve në Senatin Akademik, në Bordin e Administrimit si edhe pranë Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të këtij programi studimi, në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Institucioni përdor edhe pyetësorin për studentët për vlerësimin e procesit akademik dhe personelit</i></p>

	<p><i>pedagogjik sipas lëndëve, programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin. GVJ konstatoi se procedura e shpërndarjes së pyetësorëve të studentëve dhe mbledhja e informacionit nuk është e strukturuar mirë dhe nuk siguron pjesëmarrje të lartë duke lënë dhe paqartësi në sigurimin e anonimatit në këtë proces.</i></p> <p><i>Kuadri rregullator i USH, parashikon të drejtën e ankimit për të gjithë studentët lidhur me procesin e kontrollit të dijeve dhe vlerësimin në provim, por GVJ konstatoi se studentët paraqesin nevojë për më shumë komunikim me personelin akademik.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ konstatoi se rregullorja e Fakultetit Ekonomik parashikohen qartë procedurat dhe strukturat e dedikuara në shërbim të studentëve si Sekretaritet Mësimorë që janë në funksione administrative nën njësinë kryesore dhe Zyra e Këshillimit dhe Karrierës dhe Alumni në USH.</p> <p>Konkretisht, këto struktura në bashkëpunim me njësitë bazë të USH dhe ndihmuar nga platforma Pitagora në përdorim ndjekin të gjitha procedurat, aktivitetet dhe mbajnë e përditësojnë dokumentacionin që ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin mësimor. Sekretaritet dhe Zyra e Karrierës garantojnë informimin, këshillimin dhe ndjekjen e ecurisë së studentëve sipas programeve të studimit në nivel Fakulteti dhe në nivel Universiteti; si edhe kontribuojnë me të dhëna statistikore e duke ndjekur në tërësi problematikat e lidhura me studentët.</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Guida Për Studentët</i> <i>Rregullore E Zyrës Së Karrierës Dhe Alumnit</i> <i>Raport Nga Zyra E Këshillimit Të Karrierës Dhe Alumnit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë</p>	<p>GVJ konstatoi se rregullorja e Fakultetit Ekonomik parashikohen qartë procedurat dhe strukturat e dedikuara në</p>

<p>funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>shërbim të studentëve. Konkretisht, këto struktura në bashkëpunim me njësitë bazë të USH dhe ndihmuar nga platforma Pitagora në përdorim ndjekin të gjitha procedurat, aktivitetet dhe mbajnë e përditësojnë dokumentacionin që ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin mësimor. Sekretaritetë dhe Zyra e Karrierës garantojnë informimin, këshillimin dhe ndjekjen e ecurisë së studentëve sipas programeve të studimit në nivel Fakulteti dhe në nivel Universiteti; si edhe kontribuojnë me të dhëna statistikore e duke ndjekur në tërësi problematikat e lidhura me studentët.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Platforma Pitagora Rregullore E Mësimin Online Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Bazuar në informacionin në RVB, organigramën dhe rregulloretë të USH, rezultoi se shërbimi i këshillimit të karrierës ofrohet kryesisht nga zyra e Këshillimit të Karrierës pranë Fakultetit Ekonomik. Në takim me përfaqësuesin e zyrës, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se veprimtaria e kësaj strukture në bashkëpunim edhe me strukturat/zyrat e tjera të USH fokusohet në informim të vazhdueshëm të studentëve në lidhje me bashkëpunimet me biznesin, organizojnë trajnime dhe orientime në lidhje me praktikat profesionale, gjithashtu në gjurmimin e të diplomuarve pas përfundimit të studimeve (mbështetja e Alumni FE). FE në bashkëpunim me zyrën në kuadër të orientimit dhe rritjes së kontakteve të studentëve me tregun e punës, organizon çdo vit Panairin e Punës.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Rregullore E Zyrës Së Karrierës Dhe Alumnit Raport Nga Zyra E Karrierës Dhe Alumnit Marrëveshje bashkëpunimi me Institucione për praktikat dhe me institucione të tjera arsimore, brenda dhe jashtë vendit Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e</p>	<p>GVJ konstatoi se zyra e Karrierës në bashkëpunim me fakultetet në USH, gjurmon punësimin e studentëve të diplomuar. Aktivitetet e zyrës së Karrierës si Panairi i Punës kanë hapësirën e tyre si në faqen zyrtare të USH dhe në rrjetet sociale, ku publikohen aktivitetet dhe udhëzues për studentët.</p> <p>FE organizon dhe aktivitetin Post Panair, në mënyrë që të forcohen kontaktet e reja dhe mbi të gjitha të analizohen të gjitha mundësitë që u ofrohen studentëve të USH.</p>

autoriteteve drejtuese përkatëse.	<i>Referenca:</i> <i>Analize e pyetësorëve program studimi bachelor financë – kontabilitet</i> <i>Panairi i Punës</i> <i>Vizita në Institucion</i>			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht pasi konstatoi se Sekretaritetë Mësimore dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit të USH janë struktura në dispozicion të informimit & shërbimit të studentëve. Shërbimi i këshillimit të karrierës ofrohet kryesisht nga Zyra e Këshillimit të Karrierës. Zyra e Këshillimit të Karrierës në bashkëpunim me fakultetet në USH, gjurmon punësimin e studentëve të diplomuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe në takimin me stafin dhe studentët e USH, GVJ konstatoi se USH ka struktura dhe procedura të mirëpërcaktuara për SBC në përputhje me strategjinë institucionale dhe kuadrin ligjor në fuqi. FE ka ngritur NJSBC-në në nivel fakulteti e cila funksionon në përputhje me rregulloren e NJSBC-së së USH. <i>Referenca:</i> <i>Manuali I Cilësisë</i> <i>Vendim I Senatit Për Krijimin E Komisionit Për Garantimin E Standardeve Të Cilësisë Në Ush Dhe Programeve Të Studimit Paketa E Instrumenteve Matës Të Cilësisë Në Ush</i>

<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>NJSBC është pjesë e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë. Kjo njësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - harton politika dhe procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë, vlerëson periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore; - realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga institucioni i arsimit të lartë; - harton dhe i propozon Senatit standardet për sigurimin e cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë; - prezanton raportin vjetor të vlerësimit të brendshëm të cilësisë së USH-së në Senatin Akademik, i cili miraton raportin vjetor përfundimtar të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në USH. <p>Njësia bazë vlerëson dhe miraton raportet mbi monitorimin e aftësive të mësimdhënies dhe inovative të personelit akademik.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm 2017-2020</i> <i>Rregullore NJSBC – FE</i> <i>Vendim anëtarit i NJSBC- FE</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Kuadri rregullator i USH u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi: cilësinë e procesit mësimor; format e ndryshme të mësimdhënies; vlerësimin dhe kontrollin e dijeve; etj përmes pyetësorëve përkatës të realizuar nga NJSBC (rregullore neni 8), në nivel fakulteti.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Analizë e pyetësorëve program studimi bachelor financë – kontabilitet</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë, pra NJSBC referuar dhe rregullores se saj, raporton mbi vlerësimet e mbledhura së pari tek personeli akademik dhe strukturave vendimmarrëse të fakultetit. Këto raporte janë pjesë e diskutimeve brenda departamentit duke reflektuar gjithnjë drejt përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Rregullore NJSBC – FE</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>

<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB dhe DVV, gjithashtu dhe nga vizita me stafin dhe përfaqësues së NJSBC, GVJ konstatoi se raportet e vlerësimeve të personelit duke u bërë pjesë e mbledhjeve në departament, ka si qëllim dhe diskutimet konstruktive, të cilat promovojnë praktikën e mira dhe nxisin personelin akademik për përmirësim të mëtejshëm.</p> <p><i>GVJ rekomandon angazhimin e institucionit për nxitjen dhe promovimin e pedagogëve përmes pjesëmarrjes në trajnime dhe projekte të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit.</i></p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Raporti i punës mësimore dhe shkencore për vitin akademik 2021-2022</i></p> <p><i>Raporti i analizës mësimore departamenti financë – kontabilitet 2021 -2022</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht pasi konstatoi se kuadri rregullator i USH u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi mësimdhënien dhe parashikon të drejtën e studentëve për ankim dhe zgjidhje. Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve në fund të çdo semestri, si dhe analizat vjetore të realizuara në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Institucioni. <u>GVJ rekomandon angazhimin e institucionit për nxitjen dhe promovimin e pedagogëve përmes pjesëmarrjes në trajnime dhe projekte të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit.</u></i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe nga vizita në institucion GVJ konstatoi se, në planin strategjik të USH, në përputhje me misionin dhe vizionin e zhvillimit të institucionit,</p>

<p>për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>dhe planifikimit strategjik, një vëmendje e veçantë i kushtohet sigurimit të cilësisë. Parimi i cilësisë vlerësohet si udhëheqës i aktivitetit organizativ të Universitetit dhe duke ndjekur kuadrin ligjorë. Në USH në nivel institucional dhe në njësitë kryesore janë krijuar komisionet për garantimin e standardeve të cilësisë dhe të programeve të studimit. Në nivel fakulteti NJSBC përbëhet, me miratim të Dekanit, nga pesë anëtarë ku tre janë personel akademik të FE, një ekspert i jashtëm dhe një student.</p> <p><i>Referenca:</i> Rregullore NJSBC – FE STATUTI I USH-se Vizita në Institucion</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe nga vizita në institucion GVJ konstatoi se, në USH është ngritur njëسيا për sigurimin e brendshëm të cilësisë, pjesë e Drejtorisë së Kurrikulave dhe sigurimit të cilësisë. Në nivel fakulteti NJSBC përbëhet, me miratim të Dekanit, nga pesë anëtarë ku tre janë personel akademik të FE, një ekspert i jashtëm dhe një student. Gjithashtu në Fakultetin Ekonomik janë ngritur grupet e RVB-ve, ku pjesë e grupit përveç stafit akademik janë dhe ekspertë të jashtëm dhe studentë.</p> <p><i>Referenca:</i> Rregullore NJSBC – FE Vizita në Institucion</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi se Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në USH realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL. Konkretisht, USH ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në vitin 2020. Me vendimin Nr.3 të Bordit të Akreditimit, datë 24.01.2020 USH ka marrë akreditimin institucional me kohëzgjatje 4 vite akademike. Vlefshmëria e këtij akreditimi përfundon më 23.01.2024. Ndërsa për programin e studimit Bachelor në Financë- Kontabilitet ky është akreditim që kryhet për herë të parë.</p> <p><i>Referenca:</i> Vendimi i akreditimit institucional Vizita në Institucion</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>GVJ vlerëson se në rregulloret dhe manualët e USH dhe FE paraqitet qartë politika e institucionit lidhur me sigurimin dhe përmirësimin periodik të cilësisë së programeve të studimit. Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie sigurohet nëpërmjet pyetësorit të studentit i cili vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie. Rezultatet e vlerësimit i vihen në dispozicion individualisht, të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjëseve të departamentit, si dhe dekanëve përkatës. Gjithashtu bazuar në dokumentacionin e DVV, FE organizon pyetësorë të veçantë për secilin pedagog dhe ua shpërndan në mënyrë elektronike studentëve.</p> <p><u>Referenca:</u> Rregullore NJSBC – FE Formati i pyetësorit + shembull një raporti për Pedagoget FE Vizita në Institucion</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstatoi se në USH procedurat dhe politikat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Ndërkohë, USH ka marrë akreditimin institucional me kohëzgjatje 4 vite akademike dhe programi i studimit Bachelor në Financë-Kontabilitet akreditohet për herë të parë.</p> <p>Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve për mësimdhënien në fund të çdo semestri si dhe analizat e ecurisë të realizuara në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Universiteti.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.3 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin</p>	<p>GVJ konstatoi nga DVV dhe RVB se në Fakultetin Ekonomik, përdoren metoda të ndryshme si, kontrollet nga drejtuesit e Njësive Kryesore, analizat dhe diskutimet në mbledhje të departamentit dhe fakultetit, anketimet e studentëve. Lektorët çdo vit dorëzojnë të drejtuesi i njësisë formularët e raporteve</p>

<p>dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>të veprimtarisë së tyre kërkimore shkencore. UDH përdor mekanizma e procese të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve sipas rregulloreve të studimit.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Formati i pyetësorit + shembull një raporti për Pedagoget FE</i> <i>Vendim departamenti për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e brendshëm</i> <i>Rregullore NJSBC – FE</i> <i>Raporti i analizës mësimore departamenti financë – kontabilitet 2021 -2022</i> <i>Analizë e pyetësorëve program studimi bachelor financë – kontabilitet</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>GVJ konstatoi nga RVB se në nivel institucional, NJSBC realizon çdo vit akademik Raportin e Vlerësimit të Brendshëm i cili paraqet një studim të funksionimit institucional të USH-së dhe përmbushjen e standardeve të cilësisë për vitin akademik. Ky raport përmbledh evidencat me anë të së cilave vlerësohet përmbushja e standardeve të cilësisë e veprimtarive akademike dhe mësimore mundëson analizimin e nevojave dhe vendosjen e synimeve për zhvillimin e cilësisë.</p> <p><u>GVJ rekomandon</u> analiza dhe raportime në nivel departamenti, ku burim informacioni të kenë jo vetëm pyetësorët e studentëve. Mbledhjet me personelin akademik në nivel departamenti dhe aktivitete të organizuara me studentët janë burim informacioni ndihmës për këto raporte të analizave lidhur me ecurinë e programeve dhe procesit mësimor, stafin akademik dhe studentët, menaxhimin e brendshëm dhe veprimtaritë ndihmëse.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Raport i RRB Institucionale</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të</p>	<p>GVJ konstatoi nga dokumentacioni i DVV dhe RVB se në nivel institucional është hartuar nga NJSBC dhe është miratuar paketa e instrumenteve matës të cilësisë në USH. Në fund të këtij viti do bëhet vlerësimi i pedagogëve duke u mbështetur në këtë paketë të vlerësimit të performancës. Përpos iniciativës</p>

<p>drejtëpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>së përmendur, metoda e drejtëpërdrejtë e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies është pyetësi i studentëve në fund të cdo semestri. Analiza e raporteve të pyetësorëve diskutohen në mbledhjet e departamentit. Gjithashtu lektorët në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme dorëzojnë në departament CV-të e rifreskuara.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>RVB Bachelor Finance - Kontabilitet 2020 -2023.docx</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Bazuar në informacionin e DVV dhe RVB, GVJ konstatoi se USH ka një paketë instrumentesh të matjes së cilësisë, e miratuar në vitin 2022, ku bëjnë pjesë: Pyetësorë për studentët mbi lëndën. Modulin; Tabelë me të dhëna nga veprimtaria e pedagogut; Raport vetëvlerësimi të lëndës nga pedagogu; Pyetësor lidhur me programin e studimit; Pyetësorë për studentët e diplomuar etj. GVJ vlerëson këtë iniciativë të pasurimit të metodave të vlerësimit të realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit Bachelor në Financë-Kontabilitet.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>RVB Bachelor Finance - Kontabilitet 2020 -2023.docx</i> <i>Plani I Punës, Manuali I Cilësisë Në Ush</i> <i>Paketa E Instrumentave Matës Të Cilësisë Në Ush</i> <i>Analizë e pyetësorëve program studimi bachelor financë – kontabilitet</i> <i>Formati i pyetësorit + shembull një raporti për Pedagogët FE</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstatoi se kuadri rregullator i USH parashikon procedura dhe mekanizma formalë për monitormin dhe rishikimin e programeve të studimit në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Në nivel institucioni NJSBC përgatit raporte vjetore me të dhëna cilësorë dhe</p>

	<p>sasiore të mbledhura nga pyetësorët e shpërndarë tek studentët, dhe evidentohen problematikat e ndeshura apo eksperiencat më të mira si dhe nxirren konkluzione apo jepen rekomandime për përmirësimin e situatës. USH së fundmi ka pasuruar kuadrin rregullator mbi metoda të reja të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit në DVV dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në USH, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i institucionit parashikon dhe garanton përfshirjen e të gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Në rregulloren e Sistemit të Brëndshëm të Sigurimit të Cilësisë përcaktohet organizimi, funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e sektorëve përbërës si dhe dokumentacioni i nevojshëm për procesin e vlerësimit të brendshëm.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Rregullore NJSBC – FE</i> <i>Vendim Anëtarit I NJSBC- FE</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në rregulloren e Sistemit të Brëndshëm të Sigurimit të Cilësisë përcaktohet organizimi, funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e sektorëve përbërës si dhe dokumentacioni i nevojshëm për procesin e vlerësimit të brendshëm. Gjithashtu, paraqitet korniza e sigurimit të cilësisë në USH, roli i strukturave akademike dhe administrative në procesin e vlerësimit të brendshëm si dhe inkurajohen studentët që të jenë pjesëmarrës aktivë në procesin mësimor duke dhënë mendime përmes procedurave të vlerësimit (pyetësorëve) dhe angazhimit në strukturat qeverisëse të USH.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Vendim Anëtarit I Njsbc- Fe</i></p>

	<i>Vendim Departamenti Per Ngritjen E Grupit Te Punes Per Vleresimin E Brendshem Plani I Punës, Manuali I Cilësisë Në Ush</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	GVJ vlerëson se USH garanton përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit duke respektuar integritetin akademik dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit apo studentëve. Pranë FE është ngritur Njësia e Sigurimi të Cilësisë me anëtarë nga personeli akademik dhe një student është pjesë e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të këtij programi studimi. <i>Referenca:</i> <i>Rregullore NJSBC – FE</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Pranë FE është ngritur Njësia e Sigurimi të Cilësisë me anëtarë nga personeli akademik dhe një student është pjesë e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të këtij programi studimi. Kjo njësi funksionon në respektim të plotë të integritetit të aktorëve. <i>Referenca:</i> <i>Rregullore e Studimit</i> <i>Rregullore Njsbc – Fe</i> <i>Rregullore E Fe-Së</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vëra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se USH angazhohet në përfshirjen e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Aktivitete si Panairi i Karrierës, leksione të hapura me personalitete të fushës, marrëveshjet e ndryshme të bashkëpunimit me institucione publike dhe private janë kthyer në një traditë në jetën universitare të USH dhe strukturat përkatëse i shfrytëzojnë edhe për ndarjen e mendimeve lidhur me cilësinë dhe përmirësimin e vijueshëm të programeve të studimit. <i>Referenca:</i> <i>Vendim departamenti për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e brendshëm</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht pasi konstatoi se kuadri rregullator i USH përcakton qartë strukturat që përfshihen në procesin e sigurimit dhe përmirësimin të vijueshëm të cilësisë së programit të studimit.</i>

	<p><i>Institucioni siguron përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit. Përmes aktiviteteve si Panairi i Karrierës, leksione të hapura me personalitete të fushës, marrëveshjet e ndryshme të bashkëpunimit me institucione publike dhe private, USH realizon përfshirjen e bashkëpunëtorëve apo ekspertëve të jashtëm në procesin e vlerësimit të cilësisë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dhënë në RVD, DVV dhe takimeve në institucion, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i USH parashikon publikimin e politikave, strategjive dhe veprimtaritë në kuadër të sigurimit të cilësisë. USH përdor faqen zyrtare të web- it dhe rrjetet sociale, komunikimin me email dhe takimet informuese në kuadër të këtij qëllimi.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Rregullore E Studimit</i> <i>Guida Për Studentët</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Publikimet në faqen zyrtare web të USH dhe raportet e analizave të zhvilluara respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Informacioni në nivel programi studimi dhe departamenti përcillet tek struktura përkatëse nëpërmjet shkresave zyrtare në pajtim me kuadrin rregullator të institucionit, ndërsa studentët informohen përmes publikimeve në faqen zyrtare ëeb të USH dhe komunikimeve në platformën Pitagora.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Programi I Transparencës</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe</p>	<p>GVJ konstatoi se pas vlerësimit të personelit akademik, raportet përcillen nga NJSBC në njësinë bazë të programit dhe FE. Raportet pasi u bëhen me dije personelit, diskutohen duke</p>

<p>synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>ndarë praktikat e mira dhe duke marrë masa për përmirësim të vazhdueshëm mbi problematikat e evidentuara.</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Raporti i punës mësimore dhe shkencore për vitin akademik 2021-2022</i></p> <p><i>Raporti i analizës mësimore departamenti financë – kontabilitet 2021 -2022</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB, GVJ konstatoi se në USH realizohen periodikisht analiza në nivel fakulteti dhe departamenti mbi ecurinë e politikave dhe strategjive, duke reflektuar dhe ndryshimet e nevojshme dhe përmirësimet e nevojshme.</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>RVB Bachelor Finance - Kontabilitet 2020 -2023.docx</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmoi aktivitet e organizuar në nivel fakulteti dhe departamenti në kuadër të përditësimit me ndryshimet dhe përmirësimet e mëtejshme. Aktivitetet si Panairi i Punës, takime të hapura, nisma mbi transparencën të publikuara dhe në faqen zyrtare të USH kanë objektiv kryesorë ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive në sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë të personelit akademik, studentëve dhe ekspertëve të jashtëm të fushës.</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p>www.unishk.edu.al</p> <p><i>Programi I Transparencës</i></p> <p><i>Mbledhje e asamblesë së fakultetit</i></p> <p><i>Relacione mbledhje departamenti</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht pasi konstatoi se USH publikon informacion të dedikuar mbi sigurimin e cilësisë me qëllim informimin e studentëve dhe të gjithë palëve të interesuara. Materialet e publikuara dhe raportet e analizave të zhvilluara respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Në raportet e analizës në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Universiteti përfshihen dhe tregues të matshëm për vlerësimin e efektivitetit të aktivitete të ndërmarra për monitorimin dhe përmirësimin e vijueshëm të cilësisë. Institucioni angazhohet për ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive të personelit dhe</i></p>

	<i>studentëve, në sigurimin dhe përmirësimin e vijueshëm të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Financë-Kontabilitet

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Institucioni gëzon emër të mirë dhe ka përvoja të mëparshme të sukseshme në programe studimi cilësore në fushën ekonomike, të cilat ofrojnë një suport të mirë për ofrimin e programit aktual të studimit;
2. Programi i studimit ofrohet në një fushë e cila perceptohet si një nevojë përherë e madhe për t'u plotësuar dhe me specialistë përkatës;
3. Institucioni ka një larmi të konsiderueshme të marrëveshjeve të bashkëpunimi me partnerë vendas dhe sidomos të huaj;
4. Institucioni është i angazhuar në projekte kërkimore të financuara brenda dhe jashtë vendit;
5. Institucioni dhe Fakulteti kanë një numër të marrëveshjeve gjithnjë e në rritje me institucionet e tjera dhe biznesin;
6. Institucioni ka dhe ofron për studentët dhe jo vetëm, bibliotekën me një fond të pasur librash në gjuhë Shqipe dhe të huaj;
7. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, si klasa, laboratorë, të pajisura me kompjutera, projektor, lidhje interneti të përshtatshme për nevojat e zhvillimit të orëve mësimore të programit të studimit Bachelor në Financë- Kontabilitet;
8. Sistem efektiv i sigurimit të cilësisë, me struktura dhe përgjegjësi të qarta, që shërbejnë përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë;

b. Pika të dobta:

1. Mungesë e politikave nxitëse financiare për personelin akademik në mbështetje të kërkimit shkencorë dhe publikimeve; (*Standarti VI.1, kriteri 5*)

2. Mosmbulimi në masën 70% i ngarkesës mësimore të programit të studimit nga staf akademik efektiv, në përputhshmëri me aktet ligjore në fuqi; (*Standarti IV.1, kriteri 2*)
3. Literatura e sugjeruar në programin mësimorë nuk është e përditësuar; (*Standarti II.3, kriteri 4*)
4. Mungesa e një studimi tregu të përditësuar të programit; (*Standarti II.5, kriteri 1 & 3*)


Rekomandime:

1. Politika nxitëse financiare duhet të hartohen në kuadër institucional, në funksion të mbështetjes së kërkimit shkencorë;
2. Mungesa e ndryshimeve në program gjatë viteve të fundit e bëjnë të domosdoshme rishikimin dhe përmirësimin e tij me qëllim shtimin e njohurive në fushën e financës dhe kontabilitetit dhe heqjen e lëndëve jo të përshtatshme për këtë program;
3. Përmirësimi në një numër të programeve të lëndëve dhe realizimi i vlerësimit gjatë vitit akademik për studentet në nivelin 40% duke ulur vlerësimin përfundimtar që është aktualisht në këto lëndë nga 80 % të pikëve totale në 60 %. Kjo do të rriste edhe angazhimin e studenteve gjatë gjithë vitit akademik;
4. Institucioni të rekrutojë staf akademik efektiv, për të mbuluar ngarkesën e orëve në auditor mbi masën 70%, në përputhshmëri me aktet nënligjore në fuqi;
5. Sugjerohet që të realizohet një studim i plote i tregut të punës me fokus tregun potencial për tu punësuar në sektorët e financës, bankës, sistemit tatimor e doganor dhe kontabilitete;
6. Rekomandohet që procedura e shpërndarjes së pyetësorëve të studentëve dhe mbledhja e informacionit të strukturohet më mirë dhe të sigurohet një pjesëmarrje më e lartë e studenteve dhe anonimati në këtë proces;
7. Rekomandohet angazhimi i institucionit për nxitjen dhe promovimin e pedagogëve përmes pjesëmarrjes në trajnime dhe projekte të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit;
8. Përditësim të literaturës bazë së sugjeruar dhe përdorur në lëndët e programit;
9. Institucioni duhet të mundësojë autonomi financiare të njësisë bazë;

Conclusions of the evaluation for the first cycle study program Bachelor in “Finance-Accounting”

a. strengths and affirmations:

1. The institution enjoys a good reputation and has previous successful experiences in quality study programs in the economic field, which provide good support for the provision of the current study program;
2. The field of study program being offered is recognized as a significant need that requires the expertise of relevant specialists;
3. The institution has a significant variety of cooperation agreements with domestic and especially foreign partners;
4. The institution is engaged in national and international funded research projects;





5. The Institution and the Faculty continuously increase the number of agreements with other institutions and business;
6. The institution offers to students and the public, the library with a rich fund of books in Albanian and foreign languages;
7. The institution offers sufficient and suitable facilities for the implementation of educational activities, including classrooms and laboratories equipped with computers, projectors, and internet connections tailored to the requirements of the Bachelor's in Finance-Accounting study program;
8. Effective quality assurance system, with clear structures and responsibilities, that serve the continuous quality improvement;

b. Weaknesses:

1. The institution has a lack of financial incentive policies in support of the academic staff scientific research and publications; *(Standard VI.1, criterion 5)*
2. Failure to meet the requirement of covering 70% of the teaching load in the study program by effective academic staff, in accordance with the current legal regulations; *(Standard IV.1, criterion 2)*
3. The literature suggested in the curriculum is not up to date; *(Standard II.3, criterion 4)*
4. Lack of updated market study of the program; *(Standard II.5, criterion 1 & 3)*

Recommendation

1. Financial incentive policies supporting scientific research should be formulated within the institutional framework;
2. The program's lack of recent updates underscores the need for a comprehensive review and improvement, focusing on enhancing knowledge in finance and accounting and eliminating unsuitable subjects;
3. Updating various subject syllabi and enhancing student assessments throughout the academic year to a 40% level, while concurrently reducing the final assessment weight in these subjects from 80% to 60%, aiming to foster increased student engagement over the course of the academic year;
4. The institution is advised to hire effective academic staff to ensure coverage of the auditorium hours workload above 70%, in compliance with the prevailing by-laws;
5. It is advisable to conduct a comprehensive study of the labor market, with a specific focus on the potential employment opportunities within the finance, banking, tax and customs systems, and accounting sectors;
6. It is recommended to enhance the structure of the student questionnaire distribution and information collection procedures to ensure increased student participation and guarantee anonymity in the process;
7. It is recommended that the institution commits to encouraging and promoting lecturers through their participation in various training programs and projects, both nationally and internationally;
8. Updating the fundamental literature recommended and used in the program's subjects;
9. The institution should grant financial autonomy to the basic unit;



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Drini Pallo